



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

Administrim Biznesi me profile:

i). Menaxhim

ii) Menaxhim i Burimeve Njerëzore

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ermira QOSJA

Prof. Asoc. Jonida TETA

Shkurt / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Shkencave në: Administrim Biznesi me profile: i). Menaxhim dhe ii) Menaxhim i Burimeve Njerëzore

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në Administrim Biznesi me profil: i) Menaxhim; ii) Menaxhim i Burimeve Njerëzore "
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 510, datë 08.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Urdhër Nr. 297, datë 20.07.2012 *
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2021 - 2022:	16 PAE / 2 PAK Ngarkesa mësimore: 89 % PAE / 11 % PAK
16	Numri i studentëve (2018-2021):	2019-2020 38 studentë; 2020-2021 50 studentë; 2021-2022 39 studentë;
17	Komente / të tjera:	-

*Forma e diplomes, regjistruar sipas këtij Urdhëri është, me emërtimin "Master i Shkencave" ne "Administrim biznesi", pa profile.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Universiteti i Tiranës (UT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.207 dt.30.05.1957. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022. Universiteti i Tiranës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute emërtuar si vijon:

- Filiali i Sarandës
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Instituti i Fizikës Bërthamore
- Instituti i Studimeve Europiane

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës është fakulteti pionier i programeve master në Shqipëri. Bazuar në eksperiencën e programit MBA të realizuar në bashkëpunim me Universitetin e Linkolnit të Nebraskës nga viti 1993, Fakulteti Ekonomik dhe më specifiku Departamenti i Menaxhimit ka konceptuar dhe hartuar Programin e Masterit të Shkencave në: Administrim Biznes me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore. Ky program në Fakultetin Ekonomik, është një nga programet më të rëndësishme të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit, i cili krijon një urë lidhëse mes programit bachelor dhe studimeve doktorale dhe nevojave të tregut të punës. Në strukturën e programeve master të Departamentit të Menaxhimit bëjnë pjesë 4 programe master: 2 mastera në nivel profesional dhe dy në nivel shkencor, të cilët janë hartuar në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë dhe në përputhje me Komizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit MSHAB janë në përputhje të plotë me ato të UT dhe kanë të bëjnë me: suksesin e studentëve dhe ekselencën akademike; avancim në kërkime, studime dhe aktivitete krijuese dhe reputacion i programeve të ofruara nga universiteti. Programi MSHAB synon të bëhet një faktor kyç në disiplinën e menaxhimit dhe lidhësit në vend dhe më gjerë. Një nga pikat e forta të programit është mësimdhënia nga një trupë akademike në përbërje të të cilit janë personalitete të disiplinës së menaxhimit në vend, me një kontribut të vyer në formimin e shkollës së biznesit në Shqipëri. Departamenti ka në përbërje 33 pedagogë nga të cilët 6 janë me titullin “Professor” dhe 6 të tjerë me titullin “Profesor i Asociuar”. Objektiva të rëndësishme të këtij programi master janë dhe lidhja e studentëve me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi.

Statistikat e programit tregojnë që përqindja e studentëve që punojnë është mjaft e lartë dhe për këtë kontribut kanë dhe pedagogët e tyre për shkak të network të pasur që ofrojnë për studentët në auditor. Programi ndërlihd më së miri ekselencën akademike dhe në kërkim, me eksperiencën në



industri dhe në raportet me industrinë të profesoratit, duke dhënë mundësinë që studentët të përgatiten për tregun e punës dhe një pjesë e tyre për hapin tjetër në karrierën akademike të tyre, studimet e ciklit të tretë të doktoraturës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Asoc.Dr. Jonida Teta. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznes me profile, i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit të Fakultetit të Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.



Vizita në FEUT, u realizua në datën 3 dhe 4 Tetor 2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në FEUT, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Zv. Dekanët të cilët mbulojnë: Ndërkombëtarizmin dhe Projektet; Kerkimin dhe Marrëdhëniet me Sipërmarrjen, si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MSHAB, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.01.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1 Prot, datë 04.01.2023. Universiteti i Tiranës përcjell në ASCAL më datë 24 Janar, me anë të shkresës me Nr. 10/ 3 Prot, datë 24.01.2023 “Mbi draft raportin e vlerësimit të Jashtëm”. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Në vlerësimin dhe gjykimin e vlerësuesve, Raporti i Vlerësimit të Jashtëm ka qenë shumë pozitiv dhe sugjerimet janë dhënë në përputhje me cilësinë që Departamenti i Menaxhimit ofron. Megjithatë jemi të hapur për të reflektuar mbi komentet, si më poshtë:


1. Në lidhje me Standardin I.5 Kriteri 1, sugjerimi i referohet formës së mbajtjes së proces - verbale (me shkrim dore) dhe jo anës procedurale e cila është plotësisht në rregull. **Pranohet komenti, raporti ndryshon.**
2. Në lidhje me Standardin I.5 Kriteri 2 – kuptojmë periudhën e vështirë, por në vlerësim të gjithë potencialit të Departamentit të Menaxhimit dhe qëndrimit të stafit gjatë takimit, që bëhet shumë më tepër në raportet me industrinë se sa formalizohet. **Komenti pranohet pjesërisht, raporti ndryshon.**
3. Në lidhje me Standardi I.5 Kriteri 3 – **Pranohet komenti, raporti ndryshon.**
4. Në lidhje me Standardi I.5 Kriteri 5 – në momentin e vizitës nuk u dha informacion mbi Strategjinë e ndërkombëtarizimit ndonëse pati dhe një diskutim, meqenëse gjërat kanë ndryshuar. **Pranohet komenti, raporti ndryshon.**
5. Në lidhje me Standardi I.5 Kriteri 6 – **Pranohet komenti, raporti ndryshon.**
6. Në lidhje me Standardin V.3. - sugjerimi ekspertëve lidhet më së shumti me një Learning Management System. Sistemi TEAMS- ndihmoi pandeminë, por nuk është system i brendshëm. **Pranohet komenti, raporti ndryshon.**
7. Në lidhje me Standardin V.8. – gjatë takimit në institucion kërkuam të kuptonim feedback e Panairit. Meqenëse ka një reflektim në dokumentacion, **pranohet komenti, raporti ndryshon.**
8. Në lidhje me Standardin VI.4. – **Komenti nuk pranohet, raporti nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Administrim Biznes” me profil: i) Menaxhim; ii) Menaxhim i Burimeve Njerëzore

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Departamenti i Menaxhimit i Fakulteti Ekonomik në vizionin e tij për programin MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore synon të jetë model në vend dhe rajon në përgatitjen e studentëve në fushën e menaxhimit, të cilët të jenë një pikë referimi për bizneset dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është në kohezion të plotë me një sërë dokumentash strategjike të qeverisë shqiptare, si: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021- 2026); Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) dhe Plani Kombëtar për integrim evropian (2020-2022).</p> <p>Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit, u përforcua mendimi dhe gjykimi që ky program synon investimin e duhur në kapitalin human, që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovativ të sipërmarrjeve shqiptare, lidhjen universitet-industri dhe është një kontributor i rëndësishëm në garantimin e një arsimit të lartë cilësor.</p> <p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik i Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 0: Raporti i GVB</i></p> <p><i>Dokumenti 55: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020)</i></p> <p><i>Dokumenti 54 Plani Kombëtar për integrim evropian (2020-2022)</i></p> <p><i>Dokumenti 52: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021- 2026)</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe	Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore ka synuar të bëhet një faktor kyç në disiplinën e menaxhimit dhe lidhshërit në vend dhe më gjerë. I



<p>konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>krijuar nga eksperiencia paraprake e një MBA me Universitetin e Linkolinit të Nebraskës, ky program ka ditur të harmonizojë përvojën amerikane me ekselencën akademike të departamentit duke ju përgjigjur më së miri nevojave të tregut të punës, por duke shërbyer dhe si një pedanë për të gjithë ata studentë që synojnë kërkimin dhe studimet e mëtejshme doktorale. Harmonizimi i teorisë me nevojat e tregut shqiptar është bërë i mundur përmes njohurisë dhe aftësisë së stafit akademik dhe kompetencës së tyre për t'u përshtatur me rastet studimore, projektet apo mikrotezat e kompanive shqiptare dhe të ekonomisë shqiptare, duke krijuar në këtë mënyrë dhe modelin e konsoliduar të Shkollës së Biznesit në Shqipëri.</p> <p><i>Dokumenti 0: Raporti i GVB</i></p> <p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik i Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe drejtuesen e departamentit, përforcaam mendimin se programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është në përputhje të plotë me vizionin e UT dhe vizionin e FEUT.</p> <p>Programi në përputhje me ndryshimet ligjore është (ri)hapur me këtë emërtim, bazuar në Urdhërin e Këshillit të Ministrave Nr.510, dt 8.11.2010 së bashku me shumë programe të tjera master të UT dhe universiteteve të tjera</p> <p>Të bindur për avantazhet që programi dhe departamenti ofron përkundrejt programeve master të fakultetit, por dhe më gjerë, drejtuesit e FEUT dëshmuuan dhe përmes një sërë statistikash që lidhen me aplikimet master, studimin e tregut të punës, etj që ky program mbetet një brand i fakultetit.</p> <p>“Shporta” e programeve master që FEUT ofron i shërben nga njëra anë formimit të profesionistëve për tregun e punës lokal dhe global, por dhe nga ana tjetër formimit të kërkuesve të rinj shkencorë dhe kjo e mundësuar nga metodologjitë e përdorura në mësimdhënie që synojnë aftësimin logjik, të menduarit kritik dhe thellimin në analizë.</p> <p><i>Dokumenti 1: Mendimi Dekanit</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UP</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 16: Urdhëri i hapjes së programit MSHAB</i></p>

	<p><i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i></p> <p><i>Dokumenti 142: Aplikimet master 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të Dosjes së plotë të programit të studimit, Silabuseve të lëndëve dhe Planit Strategjik të Programit, evidentohet që programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri për specialistë me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, në organizatat jofitimprurëse dhe në organizatat e huaja që operojnë në Shqipëri dhe më gjerë. Gjatë takimit me stafin akademik të departamentit të menaxhimit u diskutua sesi ata përcjellin njohuritë që vijnë përmes teksteve të huaja dhe realitetit shqiptar përmes rasteve studimore, projekteve, të ftuarve në auditor dhe vizitave në biznese.</p> <p><i>Dokumenti 4: Plani Strategjik i Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Cikli i dytë i studimeve në FEUT dhe tërësia e programeve Master Profesional dhe Master i Shkencave që ofrohen në të, jep mundësinë e diferencimit në trajtimin e lëndëve dhe në thellimin e njohurive dhe të aftësive në MSH për t’i përgatitur studentët për studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>FEUT prej vitesh “prodhon” pedagogun për shumë prej fakulteteve të ekonomisë në Shqipëri, pse jo dhe më gjerë. Nga ana tjetër dhe përbërja e brezave brenda departamentit të menaxhimit dëshmon se si një pjesë e studentët të shkëlqyer të MSH kanë nisur karrierën akademike. Dosja e programeve dhe silabuset e lëndëve të japin mundësinë për të gjykuar se objektivat e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, në formimin e studjuesve të ardhshëm, në formimin e individëve me aftësi të analizës kritike dhe të të menduarit kritik. Pedagogët gjatë takimit u shprehën se gjatë orës së mësimi kombinojnë disa elementë: libër; artikuj shkencorë, studentët formulojnë pyetje kërkimore duke harmonizuar konceptet teorike me të menduarit kritik.</p> <p><i>Dokumenti 0: Raporti i Vlerësimit të brendshëm periodik</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p>

	<i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas daljes së studentëve</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore fillesën e tij e ka në MBA me Universitetin e Linkolnit të Nebraskës, i cili sic dëshmon dokumenti i Rrjetit Alumni të Departamentit është ndjekur nga personalitete të cilët më pas kanë patur një pozicion dhe rol të rëndësishëm në jetën ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Cilësia e studentëve që kanë ndjekur masterin në kohë është dëshmi dhe e suksesit të programit dhe të stafit akademik të departamentit.</p> <p>Dekani i Fakultetit, gjatë vizitës në institucion shprehet që, në lidhje me përmbajtjen e programit në kohë kanë preferuar të jenë më konservatorë sepse modeli i zgjedhur është global, ndërkohë që studentët shqiptarë vështirësi kanë në kapërcimin e tranzicionit. Programi i studimit reflekton në përmbajtjen e tij, në planin mësimor dhe në mënyrën e formulimit të silabuseve të tij një sërë dokumentash si: Rregulloren e Komisionit të Kurrikulave; Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor UT 2018-2022; Rregulloren e Organizimit e Programit të Studimit MSHAB 2022.</p> <p><i>Dokumenti 77: Rrjeti Alumni i Departamentit – Shkresa Përcjellëse</i> <i>Dokumenti 13-1: Rregulloren e komisionit të kurrikulave</i> <i>Dokumenti 116: Planin strategjik të Kërkimit Shkencor UT 2018-2022;</i> <i>Dokumenti 7.1: Rregulloren e Organizimit e Programit të Studimit MSHAB 2022.</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit</p>	<p>Në Statutin e UT, neni 11 përcaktohen njësitë kryesore dhe bazë të UT. Departamenti i Menaxhimit është një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik. Në Rregulloren e UT, të miratuar me</p>

<p>prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>vendimin Nr. 5, 2010 të Senatit Akademik dhe të përmirësuar disa here, përmes disa vendimeve, në Nenin 12 paraqitet Departamenti i Menaxhimit si një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik.</p> <p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, funksionon në përputhje të plotë me Rregulloren e UT, programi ka 120 ECTS, me dy profile: i) menaxhim: ii) menaxhim i burimeve njerëzore. Afati i studimeve dhe organizimi i vitit akademik përcaktohet respektivisht nga neni 32 dhe 33 i Rregullores së UT.</p> <p>Struktura e programit përmban veprimtari (sipas Neni 34 dhe 35 i Rregullores së UT):</p> <ul style="list-style-type: none"> - formuese – Kategoria A; - karakterizuese – Kategoria B - ndërsiplinore – Kategoria C - plotësuese – Kategoria D - përmbyllëse – Kategoria E <p><i>Dokumenti 5: Rregulloren e përditësuar e UT</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UT;</i> <i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i Programit Msc në Administrim Biznes me dy profile: i) menaxhim: ii) menaxhim i burimeve njerëzore, është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT, që përcaktojnë Departamentin e Menaxhimit si njësi bazë të njësisë kryesore Fakulteti Ekonomik. Struktura e programit është në përputhje të plotë me Rregulloren e UT (Neni 34 dhe 35) dhe organizimi i studimeve bëhet bazuar në disa nene të Rregullores së UT, më specifikisht Neni 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40). Në Rregulloren e Programit të Studimit qartësohet: Organizimi i programit të studimit -Neni 6; Struktura e Programit të Studimit – Neni 7; Elementët e Strukturës së Programit – Neni 8; Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimor – Neni 9 dhe Plani mësimor- Neni 10.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregulloren e përditësuar e UT</i> <i>Dokumenti 7.1: Rregullore e Programit të Studimit MSHAB 2022</i> <i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Ndonëse realiteti i biznesit shqiptar lidhet kryesisht me biznesin e vogël dhe të mesëm, tranzicioni i gjatë ka shtruar përpara tij nevojën për profesionistë në menaxhim. Sot më shumë se kurrë tregu i punës në Shqipëri, por dhe më gjerë është në kushtet e një kërkese agresive për burime njerëzore të mirëformuara dhe që kanë aftësi për të analizuar, menduar në mënyrë kritike, menaxhuar inovacionin në situata shumë më komplekse dhe më të paqarta se disa vite më parë.</p> <p>Qëllimi i formimit në këtë program studimi duket jo vetëm që është në përputhje me strategjitë kombëtare por gjykojmë që synon të përgatisë studentët për një botë globale. Pedagogët gjatë takimit u shprehën se si përmes programit, gërshetimit të lokale dhe globale, përipiqen të krijojnë një strukturë programi që përgatit studentët si me aftësi menaxheriale që koha kërkon.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i> <i>Dokumenti 52: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021-2026)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit ka hartuar një sërë dokumentash në përputhje me vizionin e institucionit dhe dëshirën e mirë për të ofruar një program Msc në Administrim Biznes që është model për vendin dhe rajonin dhe një pikë referimi për bizneset dhe shoqërinë shqiptare e më gjerë.</p> <p>Plani Strategjik i Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është një dokument serioz i hartuar nga departamenti në të cilin qartësohen objektivat, vlerat dhe bëhet analiza SWOT, me qëllim të dizenjimit të rrugës për të ardhmen e programit.</p>

<p>cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në këtë plan, të hartuar nga grupi i punës me pedagogët më në zë të Menaxhimit në vend, përmes një metodologjive shkencore, bëhen evidente objektivat në procesin akademik, duke theksuar përsosmërinë akademike, mbështetjen e studentëve, lidhjen me tregun e punës dhe ndërkombëtarizmin; si dhe objektivat në lidhje me kërkimin shkencor. E rëndësishme të theksohet është që departamenti ka ngritur dhe një grup për zbatimin e saj të drejtuar nga Përgjegjësja e Departamentit. Në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit, gjejmë të formuluar objektivat formuese të programit, të cilat në thelbin e vet synojnë formimin e profesionistëve të menaxhimit në funksionet kryesore të biznesit dhe të organizatës, thellimin e njohurive të menaxhimit dhe aftësimin për kërkim shkencor, fuqizimi i të menduarit dhe analizës kritike, përqsja ndaj kreativitetit dhe inovacionit, si dhe përgatitja për një karrierë të suksesshme.</p> <p><i>Dokumenti 4: Plani Strategjik i Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është mbështetur fillimisht në përvojën pozitive të krijuar nga MBA me Universitetin e Linkolnit të Nebraskës. Kjo përvojë me dimension amerikan e global i ka dhënë mundësinë stafit akademik të aftësohet e zhvillohet për një periudhë të gjatë pranë këtij universiteti, por gjithashtu të marrin kurrikulat, literaturën dhe metodologjitë e mësimdhënies duke i dhënë programit një dimension në përputhje me nevojat e tregut global, dëshmi e qartë janë dhe statistikat e Alumni të këtij masteri.</p> <p>Gjatë bisedës me drejtuesit e fakultetit dhe takimit me pedagogët e departamentit, ata theksuan se bashkëpunimi me tregun e punës, bizneset e rëndësishme në vend shkon përtej dokumentave formalë, pjesë e dosjes së aplikimit për akreditim të programit MSHAB, me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore. Në takimin me studentët gjithashtu ata u shprehën se pedagogët e departamentit ofrojnë shpesh mundësi punësimi dhe intershipi për ta.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit, që të formalizojnë më tej marrëdhëniet me biznesin, përtej dokumentave të paraqitura në dosjen e akreditimit.</u></i></p>


	<p>FE si fakulteti më i madh dhe me studentët më të mirë në tregun e arsimit të lartë, është një HUB i rëndësishëm për botën e biznesit dhe të organizatave të mëdha, rëndësinë e këtij bashkëpunimi e ka ngritur në nivel Zv.Dekani.</p> <p>Departamenti ka hartuar një dokument serioz “Studim për tregun e punës pas daljes së studentëve”, ku dëshmohet për përqindjen e lartë të studentëve të punësuar, ndërkohë që përqindja e studentëve që punojnë në përputhje me diplomimin në MSHAB, me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore mund të jetë një mundësi për diskutime e gjykime të mëtejshme në department (ndonëse dhe vlerësuesit e jashtëm janë koshientë për problematikat e tregut të punës, ku motivi kryesor i të sapodiplomuarve mbetet shpërblimi financiar).</p> <p><i>Dokumenti 30: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për MSHAB e praktikën profesionale</i></p> <p><i>Dokumenti 31-08: Publikime në WEB për mundësinë e punësimit të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 28: Të dhëna tabelore mbi punësimin real të studentëve të MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 31-6: Të dhëna tabelore mbi panairin e punës</i></p> <p><i>Dokumenti 77- Rrjeti Alumnit- Shkresa përcjellëse</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësi, shkathtësi e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Kemi theksuar disa herë në këtë raport që ky program është mbështetur në programin e MBA së Universitetit të Linkolnit, duke reflektuar ndryshimet ligjore pas angazhimit të Shqipërisë për të implementuar Procesin e Bolonjës.</p> <p>Një program MSH në Admistrim Biznes me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore që mbështetet në eksperiencën globale natyrisht përbën një avantazh, por në takimet me pedagogët dhe drejtuesit e departamentit/fakultetit ata u shprehën që përmes rasteve studimore, projekteve në skuadër, të ftuarve në auditor, vizitave studimore në kompani, praktikave dhe punimeve të diplomave ata mundësojnë lidhjen e kompetencave me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu, një pjesë e pedagogëve për shkak të ekspertizës së tyre si konsulentë në organizata dhe biznese shërbejnë si urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës. Drejtuesja e departamentit shprehet që përmes fokus grupeve me studentët e programit synojnë të kuptojnë më mirë nevojat e tyre dhe të përshtaten në</p>

	<p>punën e tyre, tregu është në lëvizje shumë dinamike dhe pedagogët e programi duhet t'i reflektojnë ato. Bazuar në dokumentin "Të dhëna tabelore mbi punësimin real të studentëve të MSHAB, me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore" rezultojnë që 41/84 studentë pra 48% e studentëve janë punësuar në përputhje me diplomën e fituar.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në dokumentin "Studim për tregun e punës pas daljes së studentëve" zë dhënia dhe interpretimi i rezultateve të pyetësorit të gjurmimit. 43% e studentëve shprehen që nuk punojnë në përputhje me programin e studimit në MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe kjo për shkak të shpërblimit financiar që marrin në pozicionet ku janë. Ndërkohe në këtë dokument, por dhe në takimin me studentët kërkojnë një përfaqësim me proaktive të departamentit në lidhje me praktikën, punën kërkimore dhe lidhjen me TIK.</p> <p><i>Dokumenti 17: Studim për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 28: Të dhëna tabelore mbi punësimin real të studentëve të MSHAB;</i></p> <p><i>Dokumenti 51: Proces Verbal mbledhjesh dhe Vendimesh</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosje e plotë e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, është hartuar dhe zbatohet në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe gjithë kornizës ligjore dhe rregullatore të MAS në këtë drejtim, ku një aspekt i rëndësishëm është mobiliteti i studentëve si brenda (transferimet) ashtu dhe jashtë vendit.</p> <p>FEUT ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjes për shkëmbimet studentore dhe të stafit. Në mënyrë periodike në WEB, publikohen mobilitetet ERASMUS për studentët e FEUT dhe të programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore. Gjithashtu në WEB, publikohen dhe thirrjet për mundësi punësimi, të panairit të punës, të konkurseve dhe aktiviteteve të ndryshme.</p> <p><i><u>GJVJ sugjeron Departamentin, që të dokumentojë dhe përfshirë në silabuse shumë aktivitete që realisht pedagogët e</u></i></p>

	<p>departamentit zhvillojnë dhe krijimin e një database të departamentit, vecanërisht për lidhjet me industrinë.</p> <p><i>Dokumenti 31-3: Publikime në WEB mbi mobilitetet për studentët</i> <i>Dokumenti 31-8: Publikimi në WEB i mundësive për punësim</i> <i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i> <i>Dokumenti 27: Të dhëna tabelore mbi transferimet</i> <i>Dokumenti 28: Të dhëna tabelore mbi punësimin real të studentëve të MSHAB</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është programi master më tradicional që një Departament Menaxhimi ofron. Sipas drejtuesve të Fakultetit dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, ky program është mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përvojën e shkëlqyer që programi MBA i hapur në vitin 1993 në bashkëpunim me Universitetin e Linkolnit të Nebraskës krijoi në FEUT; - aspektin ligjor dhe rregullator të MAS në përputhje me kërkesat e Procesit të Bolonjës; - Programin Master të Universitetit të Bolonjës dhe George Washington University; - në shumë eksperiencat tjera që vijnë përmes marrëdhënieve bilaterale, por dhe projekteve ndërkombëtare në të cilat FEUT dhe më specifikisht departamenti është përfshirë në kohë; - bashkëpunimin me organizata lider në tregun shqiptar si: Balfin, BKT, Eurosig, ERE, Këshilli i Investimeve, etj; <p><i>Dokumenti 14: Dosje e plotë e programit</i> <i>Dokumenti 57: Programi MBNJ në GËU</i> <i>Dokumenti 58: Programi master Bocconi</i> <i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i> <i>Dokumenti 33: Raporti analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me</p>	<p>Në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, më specifikisht pjesën që lidhet me Programin dhe Planin Mësimor të tij, Praktika zë 12 kredite dhe 300 orë mësimore.</p>



<p>qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Praktika mësimore me studentët e masterit reflekton kryesisht të njëjtën qasje dhe problematike si në IAL-të e tjera. Studentët pjesa më e madhe punojnë (në rastin e studentëve të MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, mbi 80% e tyre) në këto kushte praktika zakonisht konsiderohet e zhvilluar në vendin e tij të punës që përputhet ose jo me programin e studimit.</p> <p>Për studentët që nuk punojnë fakulteti ndërmjetëson me organizatat/bizneset. Praktika mësimore zhvillohet bazuar në silabus, ndërkohë Departamenti i Menaxhimit ka hartuar Udhëzuesin e Praktikës Mësimore. Në mbrojtjen e praktikës, studenti duhet të paraqesë tre dokumenta: relacion mbi praktikën e zhvilluar, Formularin e Vlerësimit nga pedagogu përgjegjës, Formularin e Vlerësimit nga mbikqyrësi në vendin e zhvillimit të praktikës.</p> <p><i>Formaliteti që shoqëron praktikën në çdo IAL është një çështje sensitive e të gjithë sistemit të arsimit të lartë, institucionet ndoshta duhet të mendojnë rrugë dhe zgjidhje në këtë drejtim.</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosje e plotë e programit</i></p> <p><i>Dokumenti 18-13: Silabusi i Praktikës Mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 81: Udhëzime mbi praktikën mësimore</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore ofrohet në gjuhën shqipe. Një mundësi e mirë për të organizuar module/tema të veçanta në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht është përmes pedagogëve të ftuar që vijnë në FEUT përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, Erasmus KA1 përfshirë.</p> <p>Hapi i parë drejt thithjes së studentëve të huaj është bërë përmes miratimit të programit të Bsc në gjuhën angleze nga ana e Departamentit të Menaxhimit. Në programin MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, silabuset e lëndëve përmbajnë literaturën në anglisht.</p> <p><i><u>GVJ sugjeron Departamentin e Menaxhimit, që të punojnë drejt programeve në gjuhën angleze dhe të programeve të përbashkta, nisur dhe nga eksperiencia dhe reputacioni që krijuan në vite me MBA me Universitetin e Nebraskës.</u></i></p>



	<p><i>Gjithashtu, sugjerim tjetër është që të nxisin më shumë studentët e MSHAB për shkëmbimet studentore në universitetet partnere me Erasmus KA1.</i></p> <p><i>Dokumenti 31-12: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Dr. Kielce (Poloni)</i></p> <p><i>Dokumenti 31-13: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Prof.Asoc.Laguera</i></p> <p><i>Dokumenti 18-1: Silabuset e lëndëve të ofruara në 2021-2022 (anglisht)</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 124: Urdhër Nr.110 MAS dt. 4.03.2022 – Për mësimdhënien në gjuhën angleze të disa programeve të UT.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>FEUT përgatit në gjuhën angleze silabuset, programin dhe suplementin e diplomës. Në lidhje me literaturën në gjuhë të huaj, ajo ofrohet në bibliotekën e fakultetit, në platformën JStore e cila mund të aksesohet dhe jashtë fakultetit. Gjithashtu pedagogët përmes platformës TEAMS ndajnë libra, artikujt dhe raste studimore në gjuhën angleze për studentët. Dokumentacioni si proces-verbalet, provimet, temat e diplomës dhe rregjistri themeltar janë në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Dokumenti 18-1: Silabuset e lëndëve të ofruara në 2021-2022 (anglisht)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike</p>	<p>Programi i studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit i FEUT, është mbështetur në tre shtylla kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Së pari</i>, FEUT ka një përvojë të hershme në fushën programeve master. Eksperienca e krijuar që në vitin


për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

1993 me programin MBA dhe sukcesi i tij në tregun e arsimit të lartë, mbeten shumë të rëndësishme në kultimin e një kulture cilësie dhe përgjegjshmërie brenda departamentit. Gjithashtu, duhet theksuar që në formatin që është sot MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore ekziston që në vitin 2010 dhe kjo është një përvojë e vyer, por gjithashtu një bazë e rëndësishme për të reflektuar mbi përditësimin e përmbajtjes së tij;

- *Së dyti*, stafi akademik, Departamenti i Menaxhimit ka në përbërje të tij 33 pedagogë të brendshëm, të cilët përbejnë stafin që mban përgjegjësinë për t'u angazhuar në këtë program, 4 pedagogë të tjerë janë pjesë e departamenteve të tjera. Duhet theksuar që stafi akademik i departamentit është një nga pikat më të forta të këtij programi studimi; Në vitin 2021-2022 janë angazhuar në mësimdhënie 16 pedagogë të brendshëm, dhe dy pedagogë të jashtëm, nga të cilët: 5 Prof.Dr; 6 Prof.Asoc.Dr; 3 DR, 1 PhD cand dhe 3 Msc. Në vitin 2020-2021 janë angazhuar në mësimdhënie 15 pedagogë të brendshëm dhe 3 pedagogë të jashtëm, nga të cilët: 7 Prof.Dr.; 5 Prof.Asoc; 2 Dr; 1 PhD cand dhe 3 Msc. Në vitin 2019-2020 janë angazhuar në mësimdhënie 14 pedagogë të brendshëm dhe 1 pedagog i jashtëm, nga të cilët: 7 Prof.Dr.; 4 Prof.Asoc; 2 Dr; 1 PhD cand dhe 1 Msc. Ndërsa në drejtimin e punimeve të diplomës janë angazhuar për vitin 2021-2022 – 22 pedagogë; për vitin 2020-2021 - 22 pedagogë dhe për vitin 2019-2020 – 22 pedagogë, nga të cilët në dy vite është angazhuar dhe 1 pedagog Msc.

Në studimet Msc angazhimi i pedagogëve duhet në nivelin e gradës Doktor e lart dhe GVJ sugjeron që Departamenti duhet të bëjë sistemimet e minimale në këtë drejtim.

- *Së treti*, infrastruktura, Fakulteti Ekonomik ofron mjediset e nevojshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, në godina të ristrukturuara të konceptuara në mënyrë bashkëkohore dhe me mjetet e nevojshme visuale për zhvillimin e mesimit. Gjithashtu, gjatë vizitës u evidentua rikonceptimi i hollit të FEUT dhe



	<p>vendosja më pranë studentëve e Zyrave në shërbim të tyre;</p> <p><i>Dokumenti 22: Të dhëna mbi personelin të përfshirë në program;</i> <i>Dokumenti 40: Të dhëna mbi infrastrukturën në dispozicion</i> <i>Dokumenti 102: Raporti vjetor FEUT 2020-2021;</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore 2022. Në Statutin e UT, neni 11 përcaktohen njësitë kryesore dhe bazë të UT, ku Departamenti i Menaxhimit është një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik. Në Rregulloren e UT, të miratuar me vendimin Nr. 5, 2010 të Senatit Akademik dhe të përmërsuar disa here, përmes disa vendimeve, në Nenin 12 paraqitet Departamenti i Menaxhimit si një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik. Në Standartet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Fushave të Studimit, programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore i përket kodit 0413 – shkenca e menaxhimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, që lidhen me këtë program studimi janë pjesë e këtij klasifikimi.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregulloren e përditësuar e UT</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UT;</i> <i>Dokumenti 7.1: Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB 2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB 2022. Në Statutin e UT, neni 11 përcaktohen njësitë kryesore dhe bazë të UT, ku Departamenti i Menaxhimit është një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik. Në Rregulloren e UT, të miratuar me vendimin Nr. 5, 2010 të Senatit Akademik dhe të përmërsuar disa here, përmes disa vendimeve, në Nenin 12 paraqitet Departamenti i Menaxhimit si një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik.</p> <p>Në Standartet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Fushave të Studimit, programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore i përket kodit 0413 – shkenca e</p>

	<p>menaxhimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, që lidhen me këtë program studimi janë pjesë e këtij klasifikimi.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregulloren e përditësuar e UT</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT;</i></p> <p><i>Dokumenti 7.1: Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, për vetë përmbajtjen e lëndëve që ka menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Menaxhimit. Në nenin 5 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit paraqiten kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë. Në funksion të mbarëvajtjes së punës në administrimin e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Departamenti në përputhje me Rregulloren e Organizimit të Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore– Neni 17, përcakton koordinatorin e programit i cili është personel akademik dhe ka për detyrë ta ndjekë në përditshmëri programin e studimit, me qëllim administrimin më efikas të tij dhe përmirësimin e vazhdueshëm, përmes sugjerimeve që sjell në departament. Departamenti përpilon në mënyrë periodike raporte për ecurinë e punës së tij. Në Analizën Vjetore të Punës Mësimore, Kërkimore dhe Shkencore të Departamentit të Menaxhimit për vitin akademik 2020-2021 gjejmë të analizuar: ngarkesën mësimore dhe një sërë sugjerimesh për përmirësimin</p>

	<p>e procesit mësimor; analizën e rezultateve të studentëve dhe të mësimdhënies, e cila vjen e detajuar sipas programeve të studimit dhe lëndëve; kërkimin shkencor me disa rubrika nga botimet, në mobilitetet, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe lokale. Në veprimtarinë e Departamentit vend të vecantë zënë dhe mbledhjet dhe vendimet që merren, të cilat pasqyrohen në proces –verbalet e mbledhjeve.</p> <p>Në nivel Fakulteti hartohen raportet vjetore në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe të Udhëzimeve përkatëse të MAS. Në Raportin e FEUT për vitin 2020-2021 evidentohet qartë që Departamenti i Menaxhimit është proaktiv, ai është i angazhuar si në punën shkencore dhe në atë me projekte lokale dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Dokumenti 6: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7.1: Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 341: Vendim për emërimin e koordinatorit të MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Dokumenti 51: Procesverbal mbledhjesh dhe vendimesh</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Eksperienca dhe tradita që Fakulteti Ekonomik ka brenda UT ne shumë vite, krijon oportunitete për bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit. Nëse do t'i referoheshim dokumentit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të UT, evidentohet që shumë prej marrëveshjeve janë të fokusuara në fushat që FEUT mbulon duke përbërë një hapësirë shumë të frytshme për punën shkencore, projektet ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin e këtij fakulteti. Gjithashtu, në Raportin vjetor të FEUT 2020-2021 vihet re që stafi i departamentit të menaxhimit ka një përfshirje të konsiderueshme në mobilitete, projekte lokale dhe ndërkombëtare, duke përbërë një avantazh të rëndësishëm të tij brenda UT dhe në mjedisin e Arsimit të Lartë në Shqipëri</p> <p>FEUT dhe Departamenti kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me organizata publike dhe kompani private dhe sic shihet në Tabelën Përmbledhëse të institucioneve bashkëpunuese me MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe praktikën profesionale, roli i departamentit është i rëndësishëm. Akreditimi i programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve</p>

	<p>Njerëzore ndodh pas një periudhe të vështirë, ku shumë nga aktivitetet u ndërpre, megjithatë <i>Departamenti i Menaxhimit dhe FEUT mund të ndërtojnë skema formale të bashkëpunimit me industrinë duke synuar jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/interhipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentin etj.</i></p> <p>Gjatë vizitës në FEUT, ekspertët u njohën dhe zhvilluan takime me Zv. Dekanet. Në nivel fakulteti, në strukturën e dekanatit janë katër Zv Dekane, ku një nga prej tyre ka fokus ndërkombëtarizimin dhe një tjetër marrëdhënien me sipërmarrjen. Një strukturë e tillë dëshmon për seriozitetin dhe fokusin në bashkëpunime të FEUT.</p> <p><i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UT</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i FEUT</i></p> <p><i>Dokumenti 30: Tabela Përmbledhës e institucioneve bashkëpunuese me MSHAB dhe praktikën profesionale</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>FEUT për shkak të traditës dhe cilësisë së studentëve, është një pikë referimi për institucionet publike, organizatat e rëndësishme në vend, kompanitë e mëdha të biznesit, sistemin banker etj. Për këto arsye, po dhe për faktin që një pjesë e pedagogëve gëzojnë reputacion në jetën ekonomike dhe sociale në vend, marrëveshjet formale dhe lista e institucioneve bashkëpunuese është e kufizuar. Gjatë takimeve në FEUT, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karriere të tyre. Studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore punojnë (mbi 80% të tyre), në këto kushte praktika mësimore zhvillohet kryesisht në vendin e punës ku ata janë. Praktika mësimore ka nevojë të strukturohet dhe formalizohet më shumë, dhe në këtë përprjekje Departamenti ka përgatitur dhe një Udhëzues të Praktikës Mësimore</p> <p>Me ndryshimet infrastrukturore, Qendra e Karrierës ka një vendodhje të dukshme në tërësinë e zyrave në shërbim të studentit në hollin e FEUT dhe për vitin akademik 2021-2022 ka zhvilluar një sërë aktivitetesh, ka bërë shumë publikime në WEB. Me ndryshimet infrastrukturore, Qendra e Karrierës ka</p>




22



	<p>një vendodhje të dukshme në tërësinë e zyrave në shërbim të studentit në hollin e FEUT dhe për vitin akademik 2021-2022 ka zhvilluar një sërë aktivitetesh, ka bërë shumë publikime në WEB. Në Planin Strategjik të Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore bashkëpunimi dhe marrëveshjet formale me industrinë shihen si një pikë e dobët gjatë analizës SWOT, mbi këtë bazë përbën një nga qëllimet për të ardhmen e punës së departamentit.</p> <p><i>Dokumenti 30: Tabela Përmbledhëse e institucioneve bashkëpunuese me MSHAB dhe praktikën profesionale</i></p> <p><i>Dokumenti 31-1: Publikime në WEB për mundësi praktikash</i></p> <p><i>Dokumenti 31-6: Publikime në WEB për Panairin e Punës</i></p> <p><i>Dokumenti 31-8: Publikime në WEB për mundësi punësimi</i></p> <p><i>Dokumenti 28: Të dhënat tabelore mbi punësimin real të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 12-1: Raport mbi Qendrën e Karrierës</i></p> <p><i>Dokumenti 4: Plani Strategjik i Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 81: Udhëzues mbi Praktikën Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në Planin Strategjik të Departamentit për periudhën 2022-2026 një drejtim i rëndësishëm i punës së Departamentit do jetë lidhja me industrinë, formalizimi i marrëdhënieve për praktikat mësimore. Brenda Fakultetit ka disa eksperiencë pozitive në bashkëpunimin me industrinë si me Deloitte, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Këto praktika të mira do të duhet të funksionalizohen në nivel departamenti fillimisht dhe më pas në nivel programi.</p> <p>Gjatë vizitës në FEUT, evidentuam zhvillimin pas një periudhe të vështirë të Panairit të Punës, në të cilin morën pjesë një numër i madh kompanish, mbi 70 dhe që ishte një aktivitet me ndërveprim të lartë. <i>Ngjarje të tilla duhet të shihen si pikënisje për të krijuar procese të qëndrueshme bashkëpunimi dhe formalizim të marrëdhënieve universitet/fakultet/departament-industri.</i></p> <p><i>Dokumenti 4: Plani Strategjik i Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 12-1: Raport mbi Qendrën e Karrierës</i></p> <p><i>Dokumenti 103: Raporti vjetor i FEUT 2020-2021</i></p>

	<p><i>Dokumenti 30: Tabela Përmbledhëse e institucioneve bashkëpunuese me MSHAB dhe praktikën profesionale</i></p> <p><i>Dokumenti 31-6: Publikime në WEB për Panairin e Punës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në Raportin Vjetor të FEUT pasqyrohen marrëveshjet e bashkëpunimit për kërkimin shkencor me universitetet e huaja, kryesisht europiane dhe për shkak të rritjes së intensitetit të bashkëpunimit në kuadër të projekteve Erasmus KA1 – të shkëmbimeve të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve dhe projekteve Erasmus + Capacity Building.</p> <p>Mundësitë që paraqiten në drejtim të projekteve dhe bashkëpunimeve sot janë shumë më të mëdha, Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti Ekonomik ka kapacitet për më shumë ndërveprim dhe rezultate në këtë drejtim. Në nivel fakulteti po hartohet një strategji ndërkombëtarizimi. FEUT për madhësinë dhe eksperiencën që ka, mund të rrisë rezultatin përmes krijimit të sinergjisë.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit, nisur nga perspektivat që paraqiten dhe nga kapacitetet njerëzore që disponon, ka vendosur një person në pozicionin e koordinatorit të projekteve dhe ka hartuar një Strategji të Ndërkombëtarizimit për departamentin, në të cilën janë përcaktuar qartë synimet dhe masat që duhen marrë.</p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i punës së FEUT (2020-2021)</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti Analitik i përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UT (2018-2019)</i></p> <p><i>Dokumenti 82: Strategjia e ndërkombëtarizimit e departamentit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në Raportin Vjetor të FEUT (2020-2021) një element i veçantë i trajtimit janë marrëveshjet e bashkëpunimit. Departamenti i Menaxhimit në Analizën Vjetore të Punës së tij, i kushton një trajtim të veçantë angazhimit të stafit në marrëveshjet dhe projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimit me institucione në nivel lokal dhe kombëtar. Në raportin për vitin akademik 2020-2021, nga ana e drejtueses së departamentit, sugjerohet për një angazhim më serioz dhe konsequent në raportet me industrinë të fakultetit, duke mos e lënë këtë proces vetëm në vullnetin e mirë të një apo disa pedagogëve.</p> <p>Në nivel Fakulteti hartohet dhe një raport analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, duke shërbyer për</p>



	<p>përmirësimin e punës së stafit të departamenteve dhe të programeve, MSHAB përfshirë.</p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i punës së FEUT (2020-2021)</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti Analitik i përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UT (2018-2019)</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit (2020-2021)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në FEUT puna kërkimore shkencore është e ngritur në nivel Zv. Dekani dhe përbën një nga veprimtaritë serioze të këtij institucioni. Në traditën e FEUT, cdo dy vite organizohet Konferenca Ndërkombëtare Shkencore, e cila është një nga mundësitë për të mbështetur punën shkencore të pedagogëve.</p> <p>Në Analizën Vjetore të Punës të Departamentit për vitin 2020-2021, evidentohet qartë që stafi akademik është i angazhuar në botime në revista ndërkombëtare, pjesëmarrje në konferenca, angazhim në projekte dhe botim tekstesh. Natyrisht, <i>kërkimi shkencor kërkon më shumë fonde në mbështetje të hulumtimit, botimit dhe gjenerimi i tyre varet nga politikat publike, por jo vetëm.</i></p> <p>Ky department ka në traditën e tij dhe organizimin e konferencës së studentëve si një aktivitet që krahas mbështetjes për kërkimin tek të rinjtë, krijon dhe një atmosferë pozitive pedagogë-studentë.</p> <p>Në kushtet që UT po mendon për një qendër botimesh, <i>mund të sugjerohet për një revistë shkencore të FEUT, i cili ka të gjitha kapacitetet njerëzore për një botim periodik dhe për më tepër në kushtet e hapjes së studimeve doktorale, do të ishte një mundësi për doktorandët, por dhe për komunitetin e pedagogëve</i></p>

	<p><i>Dokumenti 62: Proceeding COCEFKS volume 1</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit (2020-2021)</i></p> <p><i>Dokumenti 31-10: Publikimi në WEB i konferencës studentore</i></p> <p><i>Dokumenti 87: Propozim për ngritje strukture botuese</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në FEUT, në përbërje të dekanatit janë katër zëvendësdekanë të cilët mbulojnë respektivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimin e Cilësisë, Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me Jashtë; - Gradat dhe Titujt Shkencorë; - Anën Mësimore, Aktivitetet Studentore dhe Komunikimin; - Marrëdhëniet me Sipërmarrjet dhe Institucionet Publike; <p>Madhësia e FEUT nga pikëpamja e stafit akademik, por dhe e numrit të kuotave të doktoraturave, orienton drejtuesit e lartë të fakultetit në definimin e një tërësie kompetencash dhe përgjegjësish për zvdekanët përkatës. Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm Periodik, theksohet që në raportet përkatëse puna kërkimore-shkencore raportohet në mënyrë përshkruese, mungojnë indikatorët e vlerësimit në nivel pedagogu, departamenti, fakulteti dhe institucional.</p> <p><i>Në nivel FEUT, mund të punohet për ndërtimin e një metodologjie që mundëson vlerësimin e punës shkencore, që përcakton dhe peshon indikatorët dhe që mund të shërbejë si një nga treguesit e vlerësimit të performancës dhe të shpërndarjes së buxhetit për kërkimin shkencor.</i></p> <p><i>Dokumenti 0: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i punës së FEUT (2020-2021)</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit (2020-2021)</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti Analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 64: Përmbledhje e Aktivitetit kërkimor- shkencor të Departamentit të Menaxhimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>FEUT përmes aktiviteteve në institucion, WEB, medias dhe medias sociale përpiqet të promovojë punën kërkimore shkencore të stafit akademik.</p>



	<p>Në raportin e Vlerësimit të Brendshëm periodik theksohet që aktivitetet për 65 vjetorin e themelimit të UT kanë qenë një mundësi për këtë promovim.</p> <p>Nisma për botimin e një reviste shkencore në nivel UT duhet përgëzuar, por për madhësinë dhe kapacitetin e stafit të FEUT dhe peshën e tij në tregun e arsimit të lartë, do të ishte pozitive një botim periodik i fakultetit.</p> <p>Promovimi më i mirë i kërkimit shkencor do të bëhej përmes angazhimit në projekte ndërkombëtare dhe projekte të industrisë në Shqipëri, kjo është një hapësirë ende për t'u elaboruar në universitet tona.</p> <p>Hapi i parë i promovimit të punës shkencore është krijimi brenda departamentit i një kulture të njohjes dhe diskutimit të botimeve, projekteve individuale e në grup si dhe i citimit të njëri tjetrit.</p> <p><i>Dokumenti 90: Mbi aktivitetet promovuese për 65 vjetorin e themelimit të UT;</i></p> <p><i>Dokumenti 87: Propozim për ngritje strukture botuese;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Në nivel UT, Fakulteti dhe Departmenti janë një sërë aktesh që rregullojnë dhe mbrojnë pronësinë intelektuale. Kodi i Etikës së UT, Politika e Privatësisë FEUT; Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale; shërbejnë për konceptimin dhe realizmin e një procesi etik të punës kërkimore dhe botuese që përfshin pedagogët dhe studentët. Gjithashtu, Kodi Etikës është një element që prek të gjithë veprimtarinë e procesit mësimor, nga silabusi deri në diplomat e studentëve. Gjatë vizitës në institucion u diskutua për të gjithë angazhimin e pedagogëve ndaj kopimit, “prodhimit” në zyra të specializuara të diplomave dhe për kulturën e departamentit për t'i bërë ballë me integritet këtij fenomeni.</p> <p><i>Dokumenti 103-1: Kodi etikës së UT;</i></p> <p><i>Dokumenti 99: Politika e privatësisë FEUT;</i></p> <p><i>Dokumenti 46: Rregullore për mbrojtjen e të dhënave në UT</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve të ofruara 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave</p>	<p>Në lidhje me angazhimin e studentëve në kërkimin shkencor, në traditën e FEUT është organizimi i konferencave studentore me iniciativën e departamenteve, Departamentit të Menaxhimit</p>


vetjake në fushën e kërkimit shkencor	<p>përfshirë që ka organizaur konferencën me studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjithashtu, studenntët përfshihen në konferencën ndërkombëtare që organizon FEUT përmes angazhimit të përbashkët me pedagogët. Gjatë takimit me studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore në ambjentet e FEUT, studentët shprehën dëshirën e tyre për më shumë angazhim në punën shkencore të pedagogëve.</p> <p><i>Dokumenti 31-10: Publikimi në WEB i konferencave studentore</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Proceeding COCEFKS volume 1</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Niveli i përbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE


Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi Msc në Administrim Biznesi me profil Menaxhim dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore; është hapur në vitin 2010, me Urdhër Nr 510, datë 08.11.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullues, bazuar në VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018, azhornuar më tej me VKM Nr. 879, dt.18.12.2019 janë reflektuar në formën që programi paraqet sot në momentin e akreditimit.</p> <p>Qëllimi i programit MSHAB me dy profile është të formojë dhe aftësojë individë për tregun e punës dhe t'u krijojë atyre avantazh konkurrues në të. Mbështetur në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit, MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - kredite për semestër 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 30; - ngarkesa mësimore 3000 orë: 1350 orë në auditor; 1650 orë jashtë tij; - ngarkesa mësimore javore 20-24 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. <p>Programi strukturohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 2 lëndë (11 ECTS); - Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: për profilin menaxhim 10 lëndë (61 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 12 lëndë (65 ECTS); - Kategoria C - lëndë ndërsipinore: për profilin menaxhim 3 lëndë (18 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 3 lëndë (14 ECTS);

	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika (12 ECTS); - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma (18 ECTS). Diploma dhe suplementi i saj, janë hartuar në përputhje me legjislacionin; <p>Silabuset e lëndëve janë formuluar në përputhje me udhëzimet dhe përmbajnë elementët e koncepteve bazë /rezultatet e të nxënit / temat / kodin e etikës / orët në auditor leksion / seminar / format e kontrollit të dijes / frekuentimin / literaturën. Silabuset janë formuluar në shqip dhe anglisht.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018 për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL;</i></p> <p><i>Dokumenti 15-1: Suplementi i diplomës;</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18-1: Silabuset e lëndëve anglisht viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>MSHAB me dy profile Menaxhim dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore synon të formojë dhe aftësojë studentët në një spektër relativisht të gjerë të kompetencave menaxheriale dhe t’u krijojë avantazh konkures në tregun e punës. Gjatë vizitës në FEUT drejtuesit e tij u shprehen që kanë qenë konservatorë në ruajtjen e përmbajtjes së programit, ndonëse brenda lëndëve pedagogët përshtaten vazhdimisht me zhvillimet e reja. Objektivat e programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore janë:</p> <p>formimi profesionistëve që mund të punojnë në pozicione menaxheriale në ndërmarrje shqiptare dhe të huaja; në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në sektorin publik;</p> <p>fuqizimi i të menduarit kritik, analizës kritike dhe aftësive ndërpersonale për pozicione të mëtejshme menaxheriale dhe avancimin akademik;</p> <p>thellimi i njohurive teorike dhe aftësive praktike për kërkim të pavarur shkencor;</p> <p><i>Spektri i formimit është relativisht i gjerë (silabuset) dhe kjo shërben në kushtet e një tregu të vogël si Shqipëria, por në transformimet e reja dhe shumë dinamike që po pëson menaxhimi sot, kërkohet më shumë specializim në drejtime të veçanta. Programi nën këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm mund të kishte prezencë të më shumë elementëve inovacion,</i></p>




	<p><i>digjitalizim dhe marketing. Nën këtë këndvështrim profili i BNj mund të përshtatet.</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi MSHAB me dy profile synon të krijojë një formim dhe aftësim të plotë në fushat:</p> <ul style="list-style-type: none"> menaxhimi strategjik i organizatave prodhuese dhe të shërbimit; menaxhim operacioneve të organizatave prodhuese dhe të shërbimit; menaxhim i cilësisë të organizatave prodhuese dhe të shërbimit; menaxhim i burimeve njerëzore të organizatave prodhuese dhe të shërbimit; menaxhimi i sjelljeve në organizatat prodhuese dhe të shërbimit; menaxhim i shpërblimit të punonjësve në organizatat prodhuese dhe të shërbimit; menaxhimi i projekteve dhe kontratave në organizatat prodhuese dhe të shërbimit; <p>Nëse do t’i referohemi silabuseve të lëndëve, evidentohet që pedagogët bëjnë përpjekje të harmonizojnë metoda që përforcojnë të menduarit kritik, nxisin studentët për të eksploruar në bibliotekat online, që gërshetojnë të punuarin në grupe me analizën kritike duke i përgatitur për pozicione në nivele të ndryshme menaxheriale, por dhe për t’i përgatitur për kërkimin e pavarur shkencor. Studimi i tregut të punës pas diplomimit tregon që një pjesë e studentëve nuk punojnë në përputhje me diplomën e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, por kriteri përzgjedhës i tyre në këtë rast ka të bëjë me shpërblimin financiar.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim për tregun e punës pas diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore për gjerësinë dhe thellësinë e njohurive, metodologjive dhe aftësive që synon të përcjellë tek studentët, krijon jo vetëm mundësinë e thellimit në ekspertizën e tyre si</p>

<p>akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>menaxherë të niveleve të ndryshme, por zhvillon dhe elementë të menduarit kritik e analizës së thelluar të fenomeneve.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të programit të studimit dhe silabuseve vëren që një pjesë e lëndëve janë avancim i lëndëve të Bachelorit, ndërkohë një pjesë tjetër shërbejnë për të aftësuar studentët në lidërsip, në përdorimin e metodologjive për zgjidhjen e problemeve komplekse të biznesit dhe të organizatave. Përmes detyrave, projekteve dhe rasteve studimore, studentët aftësohen në zgjidhjen e problemeve konkrete, të punuarit në skuadër, të menduarit strategjik etj. Punimi i temës së diplomës është një tjetër element i rëndësishëm në formimin e kompetencave profesionale, sepse krahas aftësisë për të eksploruar, thelluar në literaturë, përdorimit të analizave të natyres cilësore dhe sasiore, kërkon interpretim të rezultateve, sintezë e deduksion në formulimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve, të aftëson në të shkruarin shkencor dhe të kalit durimin për punë të pavarur kërkimore.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Formati i tezës së diplomës MSH viti 2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Siç kemi evidentuar dhe më lart, ndonëse MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore fillesën e tij e ka në vitin 2010, nga pikëpamja e strukturës së programit, planit mësimor, formatit të silabuse në shqip dhe anglisht, formatit të diplomës dhe suplementit të diplomës është në përputhje të plotë me bazën ligjore. Pas miratimit të Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri në vitin 2015 dhe një sërë aktesh nënligjore që e pasuan atë si VKM Nr 41 dt.24.01.2018 dhe VKM Nr 879, dt. 18.12.2019, departamenti i menaxhimit ka përshtatur të gjithë elementët strukturore të programit. Silabuset janë në shqip dhe anglisht dhe gjatë vizitës në institucion inspektuam dhe dosjen fizike të silabuseve të departamentit dhe rezulton që është sipas VKM 41.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18.1: Silabuset e lëndëve anglisht viti 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18.3: Silabusi praktikës</i></p>



	<p><i>Dokumenti 15-1: Suplementi i diplomës MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 15: Modeli i diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr 41 dt.24.01.2018 për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi MSHAB me profile: i) menaxhim, dhe ii) menaxhim i burimesve njerëzore është strukturuar në respekt të VKM Nr 41 dt.24.01.2018 për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndë të formimit të përgjithshëm; 2 lëndë (11 ECTS); - lëndë të formimit karakterizues: për profilin menaxhim 10 lëndë (61 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 12 lëndë (65 ECTS); - lëndë ndërsiplinore: për profilin menaxhim 3 lëndë (18 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore 3 lëndë (14 ECTS); - lëndë të formimit plotësues: Praktika (12 ECTS); - detyrime përmbyllëse: Diploma (18 ECTS). Diploma dhe suplementi i saj, janë hartuar në përputhje me legjislacionin; <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Në programin MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore diploma është kategorizuar si veprimtari formuese përmbyllëse. Në se i referohemi Planit Mësimor, në Dosjen e Plotë të Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, punimi i mikrotezës realizohet në semestrin e dyte / viti 2 dhe përmban 150 orë konsultime dhe 300 orë punë individuale jashtë klase.</p> <p>FEUT dhe departamenti kanë përgatitur bazuar në përvoja të shkollave perëndimore Udhëzuesin e temës së diplomës dhe Formatin e Temës së Diplomës për programet Master i Shkencave. Gjatë takimit me studentët, ata treguan se si bashkëvepronim me pedagogët gjatë punimit për mikrotezën, përpos takimeve në department, komunikimi via email apo MS Teams.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 15-1: Suplementi i diplomës MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 15: Modeli i diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Formatin e tezës së diplomës MSH viti 2022</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022. Njësitë kryesore të UT dhe në veçanti FE përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë, ndërsa njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit përmbush kriteret ligjore që mundësojnë zhvillimin e aktivitetit në fushën përkatëse të ekspertizës.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT, është ngritur nëpërmjet Vendimit Nr.12 dt. 18.04.2012 të Senatit Akademik të UT dhe është përbërë nga 11 anëtarë. FEUT si njësi kryesore, nëpërmjet Vendimit Nr 11 dt. 28.09.2021 të Dekanatit të FEUT krijoi Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Fakultetit në përbërje të të cilit janë 8 anëtarë, ku çdo departament ka përfaqësuesit e tij. E gjithë veprimtaria e NJSBC në rang UT dhe FEUT mbështetet në rregulloret respektive të institucionit. Dega e Sigurimit të Cilësisë, e krijuar në Qershor të vitit 2021 ka hartuar një Raport për vitin akademik 2021-2022. E gjithë veprimtaria e NJSBC së FEUT për vitin 2021-2022 është bazuar në një plan.</p> <p><i>Dokumenti 118: Vendimi i krijimit të NJSBC në UT;</i> <i>Dokumenti 86: Vendimi krijimit të NJSBC FEUT</i> <i>Dokumenti 8-1. Rregullore e NJSBC –UT</i> <i>Dokumenti 8. Rregullore e NJSBC –FEUT</i> <i>Dokumenti 35: Raport i Degës së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 85: Miratimi i Planit të NJSBC të FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore</p>	<p>Bazuar në DVV dhe dokumentacionin e siguruar nga vizita në IAL, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Menaxhimit si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin</p>

dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 4. Njësia

kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

dhe strukturën akademike. Fakulteti i Ekonomisë, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka në përbërje njësitë bazë:

1. Departamenti i Ekonomiksit;
2. Departamenti i Financës;
3. Departamenti i Kontabilitetit;
4. Departamenti i Marketing Turizmit;
5. Departamenti i Menaxhimit;
6. Departamenti i Statistikë Informatikë e Zbatuar;


Fakulteti i Ekonomisë në vitin akademik 2021-2022 është i përbërë nga 464 Personel Akademik gjithsej, nga ku 175 Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe 289 Personel Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (Dokumenti 022-Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 2021-22. Tab nr. 1)

Fakulteti i Ekonomisë	PAE	PAK
Prof. Dr.	25	12
Prof. As. Dr.	40	6
Dr. / PhD.	61	58
MSc.	49	213
Totali	175	289
	464	

GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit, në vitin aktual 2021-2022, ka 77 personel akademik gjithsej, 33 pedagogë me kohë të plotë dhe 54 pedagogë me kohë të pjesshme.

Njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	1	6	1	6	1
Prof. Asoc.	6	1	5	2	5	2



	Dr./PhD.	10	10	11	11	10	17
	Msc.	11	42	11	61	2	83
	Totali	33	54	33	75	23	103
	<p>Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit titullin akademik “Prof. Asoc”.</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FE) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik; - organizimin dhe strukturën akademike; <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr 41 dt.24.01.2018 për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 0: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i></p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Stafi akademik përbën pikëm më të fortë të FE në përgjithësi dhe Departamentit të Menaxhimit në veçanti. Departamenti Menaxhimit ka në përbërje të tij 33 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët: 6 Prof.Dr; 6 Prof.Asoc.Dr.10 Dr; dhe 11 Msc.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (23 PAE / 103 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 21 / 20;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (33 PAE/ 75 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 22 / 15;</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, (33 PAE / 54 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 22 / 22;</p> <p>Për sa më sipër njësia bazë përgjegjëse për programin, e studimit i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p><i>Dokumenti 22-1: Të dhëna tabelore për përbërjen e Departamentit në Njësinë Bazë;</i></p>						

	<p><i>Dokumenti 23: Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore nuk përmban laboratore. Në praktikë janë përfshirë 22 pedagogë, bazuar në ngarkesën e departamentit. Në drejtimin e punimeve të diplomës janë angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin 2021-2022 – 22 pedagogë, 21 me grada dhe tituj dhe 1 Msc; - për vitin 2020-2021 - 22 pedagogë, 21 me grada dhe tituj dhe 1 Msc; - për vitin 2019-2020 – 22 pedagogë, të gjithë me grada dhe tituj; <p><i>Dokumenti 22-1: Të dhëna tabelore për përbërjen e Departamentit në Njësinë Bazë;</i></p> <p><i>Dokumenti 23: Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 24: Të dhënat tabelore për ngarkesën</i></p>
<p>Për Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Rregullorja e programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, e mbështetur në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Statutin e UT, Rregulloren e UT dhe të FEUT, parashikon dhe koordinonin e programit që mund të jetë përgjegjësi i departamentit ose një anëtar i tij, të paktën me gradën “Doktor”.</p> <p>Në nenin 17 të Rregullores së programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore caktohen detyrat e koordinatorit që në thelbin e tyre duhet të garantojnë mbarëvajtjen e procesit mësimor, koordinon aktivitetet për raportin vjetor të analizës së programit, rishikimin e programit, dhe sigurisht kontribuon në proceset e rekrutimit të studentëve në këtë program.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit MSHAB 2022;</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e Plotë e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe më specifikisht në Nenin 17 që përcakton detyrat e koordinatorit të departamentit, në rastin e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore përgjegjësi i departamentit, bën analizën vjetore të departamentit, duke analizuar dhe</p>

	<p>performancën e këtij programi në disa tregues. Kjo analizë e punës së departamentit, në fakt dëshmon për një sens analize dhe përgjegjshmërie, e cila ndihmon për përmirësimin e vazhdueshëm të punës në departament.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza vjetore e punës së departamentit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Programi MSHAB me profile i) menaxhim dhe ii) menaxhim i burimeve njerëzore fillesën e tij në vitin 2010 e ka të mbështetur në përvojën e MBA të Universitetit të Linkolnit të Nebraskës të hapur në vitin 1993 në FEUT. Dekani i Fakultetit gjatë vizitës në institucion u shpreh që janë përpjekur të ruajnë përmbajtjen e një programi studimi që i shërben një mjedisi global. Sot dinamikat e punësimit të studentëve janë të tilla që ata synojnë formim dhe aftësim në nivel lokal dhe global dhe përmbajtja e masterit i shërben këtij trendi. Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit, në përmbajtjen e silabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimi, kontrollit të njohurive, të ftuarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen pikërisht të bashkojnë nevojat lokale me ato globale që vijnë përmes teksteve, rasteve studimore etj. Në përvojën e FEUT, siç stafi akademik dhe drejtuesit e fakultetit u shprehën gjatë vizitës, ka kontakte dhe eksperiencë me një sërë organizatash të rëndësishme në vend si Deloitte; Balfin, BKT, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që krijojnë mundësinë e pasurimit të përmbajtjes së programit.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e Plotë e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në shqip 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim për tregun e punës pas diplomimit të studentëve</i></p>

	<p><i>Dokumenti 30: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për MSHAB dhe praktikat profesionale</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018, programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është strukturuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 2 lëndë (11 ECTS); - kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: për profilin menaxhim 10 lëndë (61 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 12 lëndë (65 ECTS); - Kategoria C - lëndë ndërsipinore: për profilin menaxhim 3 lëndë (18 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 3 lëndë (14 ECTS); - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika (12 ECTS); - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma (18 ECTS); <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018 për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL;</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është organizuar në përputhje sistemin evropian ECTS, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 30; - ngarkesa mësimore 3000 orë: 1350 orë në auditor; 1650 orë jashtë tij; - ngarkesa mësimore javore 20-24 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione/seminare/ushtime/projekte/detyra kursi. <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën</p>	<p>Në Dosjen e Programit të Studimit, Plani mësimor jep në mënyrë të detajuar dhe sipas semestrave, kreditet e lëndëve, orët në total dhe të zërthyer orë leksion, orë seminari, orë ushtrimesh dhe orë jashtë auditorit.</p>

<p>mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Për profilin Menaxhim janë 1350 orë në auditor dhe 1650 orë jashtë auditorit; - Për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore janë 1395 orë në auditor dhe 1605 orë jashtë auditorit; - Në total janë 3000 orë për secilin profil; <p>Silabuset e lëndëve në shqip dhe anglisht, përcaktojnë mënyrën e vlerësimit ku përgjithësisht është zgjedhur një sistemi vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - puna në grup (10%); - aktivizimi dhe frekuentimi (10%); - detyra shtëpie (10%); - provimi semestral (10%); - provimi final (60%); <p>Në silabus, qartësohet dhe frekuentimi/ndjekja e leksioneve dhe seminareve, që është e detyrueshme në masën 75%, bazuar në Rregulloren e FEUT. Praktika mësimore, zhvillohet në përputhje me silabusin dhe dhe udhëzuesit mbi praktikën mësimore, që përmban dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në shqip 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18.3: Silabusi i praktikës mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 81: Udhëzues mbi praktikën mësimore</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Neni 19 përcaktohen kriteret e pranimit në studentëve. Një pjesë e kriterëve janë ligjore, pjesa tjetër janë përcaktuar nga Departamenti i Menaxhimit. Preferenca është për studentë të cilët kanë mbaruar një nga programet e fakulteteve ekonomike publike dhe private në vend dhe të huaja, përfshirë këtu dhe të diplomuarit në agro-biznes. Në përzgjedhje preferohen studentët që vijnë nga FEUT si dhe kriteri më i rëndësishëm është mesatarja e studimeve bachelor. Departamenti i Menaxhimit ka përpiluar dhe një politikë të marketingut për programet e studimit, duke orientuar stafin e departamentit në qasjen e duhur të rekrutimit bazuar në ato që</p>

	<p>janë vlerat e institucionit, pikat e forta të programeve dhe rezultatet më të rëndësishme.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 49. Politika e marketingut e departamentit të menaxhimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në Dosjen e plotë të Programit të Studimit dhe në Rregulloren e Organizimit të MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, gjendet informacioni i plotë mbi elementët themelorë të programit dhe planit mësimor, të cilat janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Për të gjitha lëndët janë të formuluar silabuset në shqip dhe anglisht, në përputhje me udhëzimet, silabuset përditësohen çdo vit, natyrisht duke bërë përmirësime të vogla, sic mund të jetë përditësimi i literaturës apo përmbajtja e seminarëve. Për praktikën mësimore është formular silabusi, udhëzuesi dhe programi, tre dokumenta që lehtësojnë procesin e kryerjes së praktikës dhe e formalizojnë atë. Në lidhje me punimin e diplomës është formuluar Udhëzuesi dhe Format i mikrotezës në MSH, të cilat drejtojnë dhe formalizojnë punën e studentit dhe pedagogut udhëheqës.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në shqip 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18.1: Silabuset e lëndëve në anglisht 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18.2.: Silabuset e lëndëve në shqip 2020-2021</i></p> <p><i>Dokumenti 18.3: Silabusi i praktikës mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 81: Udhëzues mbi praktikën mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Format mikrotezë MSH</i></p> <p><i>Dokumenti 81.1: Programi i Praktikës Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore përmirësohet vazhdimisht dhe për këtë i rëndësishëm është kontributi që jep çdo pedagog, në aspektin përmbajtësor dhe të metodologjive që përdor, të cilat reflektohen në silabuset të cilat si rregull përditësohen çdo vit akademik</p> <p><i><u>GVJ sugjeron përditësim të literaturës në një pjesë të lëndëve, nisur nga shqyrtimi i silabuseve. Përtej faktit që disa autorë dhe</u></i></p>


arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	<p><i>botime mund të jenë shumë të rëndësishme për lëndën, do të ishte e përshtatshme që studentëve t'u sugjerohet literaturë e 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Gjithashtu, nisur nga fakti që programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore fillesën e tij e ka në vitin 2010, <u>sugjerohet</u> të vlerësohet nëse duhen bërë përshtatje të programit, në kuptimin e rishikimit të profileve, si dhe të disa lëndëve më pranë marketingut, inovacionit dhe dixhitalizimit.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në shqip 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18.2.: Silabuset e lëndëve në shqip 2020-2021</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, bazuar në rregulloren dhe dosjen e plotë të tij, është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 30; - ngarkesa mësimore 3000 orë; <p><u>Për profilin Menaxhim</u> janë 1350 orë në auditor dhe 1650 orë jashtë auditorit;</p> <p><u>Për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore</u> janë 1395 orë në auditor dhe 1605 orë jashtë auditorit;</p>

	<p>Në total janë 3000 orë për secilin profil.</p> <ul style="list-style-type: none"> -ngarkesa mësimore javore 20-24 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. - Viti i parë është i njëjtë për të dy profilet. <p>Lëndët me 6 ECTS kanë strukturën: 60 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 30 orë ushtrime + seminare (në funksion të tipologjisë së lëndës mund të jenë dhe 30 orë ushtrime) dhe 90 orë jashtë auditorit;</p> <p>Lëndët me 5 ECTS kanë strukturën: 60 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 30 orë ushtrime + seminare (në funksion të tipologjisë së lëndës mund të jenë dhe 30 orë ushtrime) dhe 65 orë jashtë auditorit; Lëndët me 7 ECTS kanë strukturën: 60 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 30 orë ushtrime + seminare (në funksion të tipologjisë së lëndës mund të jenë dhe 30 orë ushtrime) dhe 115 orë jashtë auditorit;</p> <p>Lëndët me 4 ECTS kanë strukturën: 45 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 15 orë ushtrime/ seminare dhe 55 orë jashtë auditorit;</p> <p>18 kreditet e diplomës ndahen në 150 orë konsultime dhe 300 orë punë e pavarur.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018, programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është strukturuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndë të formimit të përgjithshëm - 2 lëndë (11 ECTS); - lëndë të formimit karakterizues: për profilin menaxhim 10 lëndë (61 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 12 lëndë (65 ECTS); - lëndë ndërsiplinore: për profilin menaxhim 3 lëndë (18 ECTS) dhe për profilin Menaxhim i Burimeve Njerëzore – 3 lëndë (14 ECTS); - lëndë të formimit plotësues - Praktika (12 ECTS) bëhet në vitin e dytë;

<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>- detyrime përmbyllëse - Diploma (18 ECTS) në semestrin e dytë viti dytë;</p> <p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore siç kemi theksuar dhe më lart në këtë raport, mbështetet në përvojën e FE që nis me Masterin e parë në Shqipëri, pas viteve 90, MBA e përbashkët me Universitetin e Linkolnit – Nebraska dhe vijon më tej me të gjithë eksperiencën e krijuar që nga viti 2010 që ky program ka krijuar në FEUT dhe në tregun e Arsimit të Lartë në Shqipëri.</p> <p>Mbështetur në Planin Strategjik të Programit, Dosjen e Plotë të tij, Rregulloren e Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe silabuset e lëndëve, mund të themi që lëndët dhe përmbajtja e tyre, diferencojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve nga BA, u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, të thellojnë njohuritë duke u përqsatur si në funksion të nevojave që tregu lokal apo ndërkombëtar të punës, ashtu dhe qasjes drejt kërkimit e punës shkencore.</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor dhe në përmbajtjen e silabuseve, vihet re një kombinim i veprimtarive formuese, pjesa më e madhe e lëndëve kanë 30 orë në leksion dhe 30 orë seminare dhe/ose ushtrime, gjithashtu nga pikëpamja e vlerësimit të vijueshëmërisë përdoren disa forma nga detyrat e shtëpisë, angazhimi në seminare, projektet në skuadër.</p> <p><i>Një pjesë e silabuseve kanë nevojë të përditësohen me literaturën e 5 viteve të fundit, gjithashtu duhet unifikuar koncepti në silabus literaturë bazë dhe literaturë e rekomanduar.</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në gjuhën shqipe 2021-2022;</i></p> <p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018 për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton</p>	<p>Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i</p>

<p>përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>atribuon programeve Master i Shkencave. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e silabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin më të mirë të studentëve nga pikëpamja njohurive dhe aftësimit praktik, për t'ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global. Element i rëndësishëm është fokusimi i studentëve në analizë, kërkim, metodologji hulumtuese të cilat mundësojnë që më të mirët e tyre të angazhohen më tej në studimet e ciklit të tretë, apo të punojnë në njësi R&D.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në gjuhën shqipe 2021-2022;</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Studimi i tregut të punës pas diplomimit të studentëve jep një panoramë interesante, që nga njëra anë dëshmon që studentët që kanë kërkuar një punë e kanë gjetur, por nga ana tjetër një përqindje e konsiderueshme nuk punojnë në përputhje me formimin dhe arsyeja kryesore është paga.</p> <p>Studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore përfitojnë njohuri që u mundëson punësimin në organizata publike, private dhe OJF. Departamenti dhe FEUT në politikatat e tyre mbështesin angazhimin e studentëve me rezultate të mira për t'u angazhuar në mësimdhënie dhe për të nisur karrierën akademike.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim për tregun e punës pas diplomimit të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 141: Njoftim i të sapodiplomuarve për angazhim si staf akademik</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Tregu i punës është në disa dinamika lokale dhe globale, të cilat kanë kapërcyer të gjitha projeksionet e ekspertëve të hartimit të programeve.</p> <p><i>Ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit FEUT- industri, por ato kanë nevojë të formalizohen dhe të bëhen të qëndrueshme, madje dhe në nivel departamenti.</i></p> <p>Pozitive është vënia në funksion e Zyrës së Karrierës dhe pozicionimi i saj në një vend shumë të dukshëm në godinën e ristrukturuar dhe emërimi i një zvdekani për marrëdhëniet me</p>



	<p>sipërmarrjes. Pas një periudhe të vështirë, FEUT organizoi për vitin 2021-2022 Panairin e Punës i cili pati një pjesëmarrje mjaft të mirë të kompanive dhe studentëve.</p> <p><i>Sugjerohet mbajtjen e statistikave në Panairin e ardhshme, mbi intershipet dhe punësimet e realizuara.</i></p> <p><i>Dokumenti 12-1. Raport mbi Qendrën e Karrierës</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1 -14: Informacione në shërbim të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor FEUT -2020-2021</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore ofron njohuri të thelluara në disiplina të rëndësishme të menaxhimit, gjithashtu krijon mundësinë e aftësimin të studentëve në hulumtim përmes metodologjive shkencore, thellon të menduarit kritik dhe përjasjen për një aktivitet të mirëfillt shkencor. Programi përmban lëndë që formojnë studentin në lidhje me metodologjitë e kërkimit, ndërkohë punimi i mikrotezës, formati dhe udhëzimet dëshmojnë për nivelin e formimit dhe aftësimin të studentëve, të cilët mundet më pas të angazhohen në ciklin e tretë</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Format mikrotezë MSH</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përkrahje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi II.5</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit ka në përbërje të tij 33 pedagogë të brendshëm, të cilët përbejnë stafin që mban përgjegjësinë për t’u angazhuar në këtë program, 4 pedagogë të tjerë janë pjesë e departamenteve të tjera. Duhet ritheksuar që stafi</p>

	<p>akademik i departamentit është një nga pikat më të forta të këtij programi studimi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:</p>																																																
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<table border="1" data-bbox="587 450 1359 790"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>14</td> <td>1</td> <td>15</td> <td>3</td> <td>16</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Referuar tabelës 12 të dokumentit 22, personeli akademik efektiv (PAE), mbulon 89% të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022.</p> <p>Ndërsa në drejtimin e punimeve të diplomës janë angazhuar për vitin 2021-2022 – 22 pedagogë; për vitin 2020-2021 - 22 pedagogë dhe për vitin 2019-2020 – 22 pedagogë, nga të cilët në dy vite është angazhuar dhe 1 pedagog Msc.</p> <p><i>Dokumenti 22: Të dhëna mbi personelin të përfshirë në program</i> <i>Dokumenti 23: Të dhëna tabelore mbi personelin e njësisë bazë</i> <i>Dokumenti 36: Të dhëna për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i></p>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	7	-	5	2	5	-	Prof. Asoc.	4	-	5	-	6	-	Dr/Phd	2	-	2	-	3	-	Msc.	1	1	3	1	2	2	Gjithsej	14	1	15	3	16	2
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	7	-	5	2	5	-																																											
Prof. Asoc.	4	-	5	-	6	-																																											
Dr/Phd	2	-	2	-	3	-																																											
Msc.	1	1	3	1	2	2																																											
Gjithsej	14	1	15	3	16	2																																											
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pedagogët e angazhuar në mësimdhënie dhe në drejtim të punimeve të diplomës në MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore janë personalitete të disiplinave të menaxhimit në vend. Stafit akademik i programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është në gjykimin tonë pika më e fortë e këtij programi studimi. Pedagogët japin mësim dhe kontribuojnë me kërkim dhe botime në drejtimet që ata mbulojnë në këtë program studimi.</p> <p><i>Dokumenti 22: Të dhëna mbi personelin të përfshirë në program</i> <i>Dokumenti 19: CV e stafit akademik të programit</i></p>																																																
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të</p>	<p>Punimi i diplomës është një element shumë i rëndësishëm i punës së Departamentit të Menaxhimit. Pedagogu udhëheqës i diplomës është në të njëjtën kohë dhe pedagogu mbikqyrës i</p>																																																

<p>lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>praktikës mësimorë. Në drejtimin e punimeve të diplomës janë angazhuar për vitin 2021-2022 – 22 pedagogë; për vitin 2020-2021 - 22 pedagogë dhe për vitin 2019-2020 – 22 pedagogë, të gjithë me tituj dhe grada shkencore, kujtojmë që në këtë program studimi angazhohen mesatarisht 6 Prof.Dr., 6 Prof.Asoc dhe pjesa tjetër doktorë shkencash; në dy vite është angazhuar vetëm 1 pedagog me Msc. Komunikimi i pedagogëve me studentët gjatë periudhës së punimit të diplomës bëhet përmes email, MS Teams. Pedagogët për shkak të reputacionit dhe lidhjeve personale mbështesin studentët në realizimin e hulumtimeve në terren, u shpreh stafi akademik gjatë vizitës në institucion</p> <p><i>Dokumenti 22: Të dhëna mbi personelin të përfshirë në program</i> <i>Dokumenti 20: CV e stafit akademik të diplomave</i> <i>Dokumenti 113: Ngarkesa mësimore</i> <i>Dokumenti 147: komunikimi në MS Teams mes pedagogut dhe studentit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Departamenti Menaxhimit për vetë natyrën e programeve që mbulon, nuk përdor laboratore dhe mjedise të tjera të natyrës specifike. Për mbulimin e disa aspekteve të punës administrative e koordinuese dhe për lehtësimin në punë administrative të ngarkesës së drejtuesit të departamentit, pranë departamentit punon një laborante/asistente administrative. <i>Dokumenti 21: CV e laborantes</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të</p>	<p>Gjatë takimit në institucion ky kriter u diskutua në mënyrë të veçantë në nivel drejtuesish dhe stafi akademik. Programi</p>

<p>studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore është konceptuar nga një perspektivë globale, përfaqson me realitetin e mundësojnë pedagogët për shkak të ekspertizës që kanë dhe lidhjeve të qenësishme me kompani/organizata dhe tregun e punës në përgjithëso. Ky program master akreditohet pas një periudhe të vështirë për ndërveprimin njerëzor, megjithatë gjatë vitit akademik 2021-2022, FEUT organizoi Panairin e Punës, një event shumë i rëndësishëm jo vetëm në drejtim të mbështetjes në intershipe dhe punësime të studentëve, por dhe të ndërveprimit me aktorët kryesorë të tregut, për t'u konsultuar dhe marrë feedback.</p> <p><i>Dokumenti 31-14: Informacioni mbi panairin e punës;</i></p> <p><i>Dokumenti 31-6: Publikime në WEB mbi panairin e punës</i></p> <p><i>Dokumenti 30: Institucionet bashkëpunuese për MSHAB dhe praktikën</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti Vjetor i FEUT 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesja e departamentit, njëkohësisht dhe koordinatore e programit u shpreh gjatë takimit që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Gjithashtu, në nivel institucioni, bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë bëhen pyetësorë për çdo pedagog dhe lëndë mesimore, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtjshme.</p> <p><i>Dokumenti 130: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit</i></p> <p><i>Dokumenti 84: Vlerësimi i pedagogut nga çdo student</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore ka histori të gjatë në tregun e arsimit të lartë. Fillea e tij në vitin 1993 me MBA e Universitetit të Nebraskës ka sjellë që alumnit e viteve të para të jenë sot figura të rëndësishme në jetën publike në vend, e për pasojë ata kanë qenë gjithnjë një burim informacioni dhe ndërveprimi për zhvillime të mëtjshme.</p>

	<p><i>FEUT dhe departamenti duhet të vijojnë të përditësojnë database e Alumnit. Studentët me rezultate të larta, në mënyrë të vazhdueshme përbëjnë bazën e rifreskimit të stafit akademik.</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas diplomimit të student</i></p> <p><i>Dokumenti 77: Rrjeti Alumni I Departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 141: Njoftim I të diplomuarve për angazhim si staf akademik</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Njësia bazë ka disa eksperiencë pozitive bashkëpunimi në disa programe studimi. Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore tashmë është në një moment që mundet të përditësohet në përputhje me zhvillimet dhe qasjet e reja të organizatave, por dhe të sugjerimeve të aktorëve të tregut.</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza vjetore e departamentit 20-21</i></p> <p><i>Dokumenti 102 Dokumenti: Raporti vjetor i FEUT</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.7</p> <p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në Planin Strategjik të Programit të Studimit, Departamenti i Menaxhimit thekson qartë prioritetet dhe objektivat e tij, nisur nga roli që duhet të kenë në shoqëri studentët e formuar. Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore synon të jetë një pikë referimi për studimet master në nivel kombëtar dhe rajonal. Prioritetet e programit kanë të bëjnë me vazhdimin e suksesit të studentëve në tregun e punës, me reputacionin në rritje të programeve të FEUT, me thellimin e kërkimit dhe të kreativitetit, dhe mbështetjen e studentëve në tregun e punës. Programi ka vendosur një set objektivash strategjike që kanë të bëjnë me proceset akademike dhe të kërkimit shkencor, me fokus tregun e punës, plotësimin e nevojave të industrisë dhe ndërkombëtarizimin. <i>Dokumenti 4. Plani strategjik i programit</i></p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Stafi i Departamentit të Menaxhimit është një vlerë e çmuar e programeve që Departamenti i Menaxhimit mbulon. Në takimin e zhvilluar në institucion me stafin e departamentit evidentohet që kontributi i tyre në program, në strategjitë e përdorura në mësimdhënie, në format e angazhimit të studentëve dhe kontrollit të dijeve të tyre është e larmishme. Ka pedagogë që përqëndrohen në të zhvilluarit të mendimit kritik, të tjerë që kërkojnë një raport më direkt me industrinë dhe biznesin, ka prej tyre që preferojnë rastet studimore, të tjerë punën në skuadër, etj. E gjithë kjo larmishmëri dhe “karakter” profesional dhe akademik, reflektohet në takimin me ta, por shihet qartë dhe në mënyrën si kanë hartuar e konceptuar silabuset.</p> <p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik I programit MSHAB</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga silabuset e lëndëve evidentohet që studentët synohen të mbahen të angazhuar në detyra shtëpie, punë në grup, projekte dhe detyra kursi. Gjithashtu, departamenti ka patur në traditën e tij organizimin e një konference studentore si dhe përfshirjen e studentëve në konferencën shkencore të universitetit. Gjithashtu, studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore përfshihen dhe në aktivitete të tjera, si konkurse, leksione të hapura, të ftuar në auditor nga bota e biznesit dhe profesorë të huaj.</p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip 2021-2022</i> <i>Dokumenti 31 nga 1-14: Publikimet në WEB që kanë lidhje me veprimtari për studentët</i> <i>Dokumenenti 62: Proceeding COCEFKS volume 1</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Në Dosjen e Plotë të Programit dhe në Planin Strategjik të tij, janë qartësuar prioritetet dhe objektivat e planit të studimit, nga ana tjetër përmes citimit të drejtuesve të FEUT dhe stafit të programit kemi theksuar që ky program ka ambicje për të formuar ekspertë të menaxhimit që konkurrojnë në nivel rajonal e më gjerë dhe kjo do të mundësohet dhe përmes programeve në gjuhën angleze që janë objektiv i departamentit.</p> <p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik i programit MSHAB</i> <i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p>

<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Departamenti zhvillon veprimtaritë e veta të natyrës kërkimore e shkencore përmes buxhetit që i miratohet në nivel Fakulteti. Natyrisht në takim pedagogët u shprehen që nevojat e tyre për mbështetje në kërkimin shkencor janë më të mëdha se buxhetet ofrojnë. Ndërkohë mundësia e angazhimit në projekte ndërkombëtare krijon hapësira për mbështetjen në botime dhe aktivitete hulumtuese.</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza vjetore e punës së Departamentit</i> <i>Dokumenti 48: Të dhëna nga Plani financiar i programit</i> <i>Dokumenti 48.1: Kosto në nivel programi</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.8</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Puna kërkimore shkencore e stafit të Departamentit është një pjesë e rëndësishme e të gjithë veprimtarisë së tyre. Në Skedën Përmbledhëse të Punës Shkencore të Departamentit të Menaxhimit dhe në Analizën Vjetore të Punës së Departamentit vihet re qartë angazhimi i stafit të departamentit. CV e stafit akademik dëshmojnë për punën e tyre shkencore dhe angazhimin e tyre në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare. Ekspertiza e shumë prej titullarëve të lëndëve dhe gërshitimi i punës mes brezave të pedagogëve është një vlerë dhe avantazh shumë i rëndësishëm i këtij departamenti.</p> <p><i>Dokumenti 64: Skeda Përmbledhëse e Punës Shkencore</i> <i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Punës së Departamentit (20-21)</i> <i>Dokumenti 19: CV e stafit të programit</i> <i>Dokumenti 20: CV e stafit udhëheqës të diplomave</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe</p>	<p>Nëse do t'i referoheshim Raportit Vjetor të FEUT (2020-2021) dhe Analizës Vjetore të Punës së Departamentit të Menaxhimit do të evidetohej qartë kontributi i stafit akademik të Departamentit të Menaxhimit në punë kërkimore shkencore,</p>



angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë takimit në institucion, evidentuam që një nga anëtarët e departamentit ishte caktuar koordinator për projektet në nivel departamenti. Një përjasje e tillë jo vetëm mundëson lidhjen më efikase të kërkimit me projektet Erasmus, projektet kombëtare, IPA, por ishte bërë një përpjekje e lavdërueshme për një projekt HORIZON 2020</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Punës së Departamentit (20-21)</i> <i>Dokumenti 102: Raporti Vjetor FEUT (20-21)</i></p>			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	<p>Në traditën e FEUT organizohet Konferenca Ndërkombëtare çdo vit, ku pedagogët përfshijnë dhe studentët. Gjithashtu në traditën e programeve MSH të këtij departamenti është organizuar me një frekuencë të caktuar dhe një konferencë studentore. Departamenti organizon gjithashtu dhe një sërë veprimtarish me studentët në funksion të arritjes së objektivave të programit.</p> <p><i>Dokumenti 62: Poroceeding COCEFKS.volumi 1</i> <i>Dokumenti 31 nga 1 -13: Botime në WEB në funksion të studentëve</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ gjatë takimit në institucion konstatoi se stafi i FEUT nxit metodat interaktive dhe inovative të mësimdhënies. Stafi akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit të cilat janë zbatuar edhe për stafin e fakultetit me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja. Për më tepër ngritja e komisioneve të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti monitoron rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Nga takimi me stafin akademik dhe me studentet, GVJ konstatoi se përdorimi i metodave interaktive përfshinte ushtrime apo case study nga realiteti për t'i bërë modulet sa më interesante dhe praktike. Gjithashtu nga silabuset e lëndëve evidentohet që studentët synohen të mbahen të angazhuar në detyra shtëpie, punë në grup, projekte dhe detyra kursi.</p> <p>Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesja e departamentit, njëkohësisht dhe koordinatorë e programit u shpreh gjatë takimit që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Gjithashtu, në nivel institucioni, bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë bëhen pyetësorë për çdo pedagog dhe lëndë mesimore, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtejshme.</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Punës së Departamentit (20-21)</i> <i>Dokumenti 102: Raporti Vjetor FEUT (20-21)</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip 2021-2022</i> <i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas diplomimit të student</i> <i>Dokumenti 130: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike</p>	<p>Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik. Nuk rezulton që të perdoren</p>

<p>aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>vlerësime të diferencuara midis pedagogësh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore. Drejtuesja e departamentit, njëkohësisht dhe koordinatorë e programit u shpreh gjatë takimit që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me Komisionin e sigurimit të cilësisë e nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuar nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu Përgjegjësja e Departamentit zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjërimet e marra nga këto grupe fokusi, ja vë në dispozicion departamentit, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjërimeve. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo akademik nga përgjegjësi i departamentit</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Punës së Departamentit (20-21)</i> <i>Dokumenti 130: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë ka qënë organizimi i anketave dhe pyetësorëve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e kontrollit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve, si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit. Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësorëve bëheshin të ditura për departamentin për cdo semestër.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në</p>	<p>Komisioni përgjegjës për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë që është ngritur dhe funksionon në nivel fakulteti, harton raporte dhe i bën ato objekt diskutimi dhe analiza në Dekanat. Gjithashtu për departamentin përgjegjës për këtë program</p>

<p>mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>studimi janë caktuar 2 pedagogë të cilët ndjekin çështjet e cilësisë në nivel departamenti. Paralelisht njësia bazë dhe kryesore (Departamenti dhe Fakulteti) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat. Gjithashtu, në nivel institucioni, bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë bëhen pyetësorë për çdo pedagog dhe lëndë mesimore, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtejshme.</p> <p><i>Dokumenti 130: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p>
--	---

<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion evidentohet se Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësi i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembujt të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit, sic na është konfirmuar edhe në takimet me përgjegjësen e Departamentit. Por në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së Departamentit të Menaxhimit që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembujt të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit</p>
---	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies</p>	<p>Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet,</p>

<p>dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, praktikë profesionale, tema diplome. Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar</p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik I programit MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1-14: Publikimet në WEB që kanë lidhje me veprimtari për studentët</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Proceeding COCEFKS volume 1</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, në lëndë të ndryshme, stafi akademik aplikon metoda të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, në funksion të natyrës dhe vecorive së cdo lënde dhe të bazës materiale të nevojshme.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve Format e mësimi teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Gjithashtu në FEUT organizohen leksione të hapura nga lektorë të ftuar. Gjithashtu Institucioni i kushton vëmendje dhe rëndësi organizimit të konferencës studentore. Stafi është i hapur për përmirësimin dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies ndër vite. Departamenti ka patur në traditën e tij organizimin e një konference studentore si dhe përfshirjen e studentëve në konferencën shkencore të universitetit. Gjithashtu, studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore përfshihen dhe në aktivitete të tjera, si konkurse, leksione të hapura, të ftuar në auditor nga bota e biznesit dhe profesorë të huaj. Gjatë vitit akademik 2021-2022, FEUT organizoi Panairin e Punës, një event shumë i rëndësishëm jo vetëm në drejtim të mbështetjes në intershipe dhe punësime të studentëve, por dhe të ndërveprimit me aktorët kryesorë të tregut, për t'u konsultuar dhe marrë feedback.</p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip 2021-2022</i></p>

	<p><i>Dokumenti 4: Plani strategjik I programit MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1-14: Publikimet në WEB që kanë lidhje me veprimtari për studentët</i></p> <p><i>Dokumenenti 62: Proceeding COCEFKS volume 1</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1 -13: Botime në WEB në funksion të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive. Institucioni vazhdimisht organizon trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik për stafin akademik të ri si dhe atë ndihmës apo administratë për mbarëvatjen e të gjithë procesit mësimor. Gjatë takimit në institucion, evidentuam që një nga anëtarët e departamentit ishte caktuar koordinator për projektet në nivel departamenti. Një përjasje e tillë jo vetëm mundëson lidhjen më efektive të kërkimit me projektet Erasmus, projektet kombëtare, IPA, por ishte bërë një përpjekje e lavdërueshme për një projekt HORIZON 2020.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive. Një pjesë e këtij personeli janë të angazhuar në proces mësimdhënës edhe në universitete të tjera jashtë vendit dhe kjo përbën pa asnjë dyshim një avantazh të dukshëm dhe progres të evidentueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësia bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Për këtë Departamenti, si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik; • Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor; • Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies; <p>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamenti, identifikojnë problemet që duhen</p>

	<p>përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve.</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza Vjetore e Punës së Departamentit (20-21)</i> <i>Dokumenti 102: Raporti Vjetor FEUT (20-21)</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip 2021-2022</i> <i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas diplomimit të student</i> <i>Dokumenti 130: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p>			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	<p>Personeli akademik përdor diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimit që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfutur nga ky diskutim. Nga vizita në institucion mësuam se personeli akademik përpiket që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit, të përdorë case study, apo të përfshijë raste nga tregu lokal.</p>			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	<p>Programi i studimit, i nivelit master shkencor, i është larguar formës klasike së mësimdhënies. Programi ka karakter sa teorik po aq edhe praktik dhe profesional. Studentët nxiten shumë për punë të pavarur. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta dhe komunitare.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat	Nga vizita që GVJ pati në Institucion, evidentoi se godina e FEUT që përdorej edhe për këtë plan studimi, mundëson që procesi mësimor e shkencor për të gjitha programet e

<p>janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>studimeve të zhvillohet brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mësimit semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambjentet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, etj. <i>Dokumenti 144:Kapacitetet e sallave dhe laboratoreve</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambjentet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambjente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve janë të pajisur me kompjutera e projektorë. Godina e FEUT ku zhvillon mësimin ky program studim dhe ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 sipas të cilit kërkohen 2.5 m² / student.</p> <p><i>Dokumenti 022-Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 2021-22, tab 16</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>FEUT ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ iu referua se pika të forta në department mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, sic e përmendëm edhe më sipër, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë. <i>Dokumenti 144:Kapacitetet e sallave dhe laboratereve</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të</p>	<p>Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj. Literatura gjendet në bibliotekën e FEUT në versionin fizik, me</p>

<p>nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>numër të konsiderueshëm titujsh dhe kopjesh, dhe në formë elektronike të përdorshme nga i gjithë personeli akademik dhe studentët. Bibliotekat online në të cilat ka akses FEUTofrojnë një masë shumë të madhe literature në gjuhë të huaj në dispozicion të punës më të thelluar nga personeli akademik dhe studentët në fushat e programit/profilin të tyre. Departamenti informohet për botimet më të fundit në fushat e lidhura me programet e tij dhe planifikon shtimin e tyre në bibliotekë, në përputhje me procedurat e administrimit dhe ato financiare të institucionit</p> <p><i>Dokumenti 125: Biblioteka ne FEUT dhe sistemi i nformacionit</i></p> <p><i>Dokumenti120: Te dhena per biblioteken</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet teksteve mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. GVJ evidentoi që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>Dokumenti 125: Biblioteka ne FEUT dhe sistemi i nformacionit</i></p> <p><i>Dokumenti120:: Te dhena per biblioteken</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së theksohej për aksesin në librarinë online, dhe kjo rezultoi qe përdorej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin. Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>FEUT ka salla konferencash dhe ambiente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Gjithashtu në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, është edhe një laborator i teknologjisë së informacionit. Në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, FEUT ka vendosur në dispozicion të studentëve të të gjithë programeve 3 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti, ku</p>



	mund të zhvillohen seminaret që kërkojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të punohet për detyrat e kursit apo punime të tjera akademike. Ato janë të hapura gjatë gjithë ditës për studentët e FEUT			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Komunikimi i brendshëm mes stafit akademik dhe studentëve, bëhet nëpërmjet platformës Microsoft Teams ose adresave të emailit <i>Dokumenti 145: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT</i> <i>Dokumenti 147: Komunikimi I MS Teams</i>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Në FEUT komunikimi i brendshëm bëhet përmes faqes së internetit të tij që është platforma SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentit), ku i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të gjithë studentët posedojnë një adresë email @feut. <i>Dokumenti 91: Clean score nje format maili I pedagoqeve</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshires se tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë (ose të zgjedhë ndër temat që pedagogët udhëheqës kanë propozuar në Departament), të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti. Refereuar RVB, studentët zgjedhin temën 1 diplomës dhe pedagogun udhëheqës një muaj nga fillimi i vitit akademik. <i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i> <i>Dokumenti 112: Formulari i vleresimit të diplomes</i> <i>Dokumenti 114: Udhezues për përgatitjen e mikrotezes për MSH</i> <i>Dokumenti 80.1: Format mikrotezë MSH</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë, është përgjegjës për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në UT dhe për të përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien. Ky komision e zhvillon aktivitetin e vet sipas një plani kalendar të përvitshëm. Në koordinim me fakultetet dhe departamentet programohen veprimet në njësitë apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/ vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT, është ngritur nëpërmjet Vendimit Nr.12 dt. 18.04.2012 të Senatit Akademik të UT dhe është përbërë nga 11 anëtarë.</p> <p>FEUT si njësi kryesore, nëpërmjet Vendimit Nr 11 dt. 28.09.2021 të Dekanatit të FEUT krijoi Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Fakultetit në përbërje të të cilit janë 8 anëtarë, ku çdo departament ka përfaqësuesit e tij. E gjithë veprimtaria e NJSBC në rang UT dhe FEUT mbështetet në rregulloret respektive të institucionit. Dega e Sigurimit të Cilësisë, e krijuar në Qershor të vitit 2021 ka hartuar një Raport për vitin akademik 2021-2022. E gjithë veprimtarua e NJSBC së FEUT për vitin 2021-2022 është bazuar në një plan.</p> <p><i>Dokumenti 118: Vendimi i krijimit të NJSBC në UT;</i> <i>Dokumenti 86: Vendimi krijimit të NJSBC FEUT</i> <i>Dokumenti 8-1. Rregullore e NJSBC –UT</i> <i>Dokumenti 8. Rregullore e NJSBC –FEUT</i> <i>Dokumenti 35: Raport i Degës së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 85: Miratimi i Planit të NJSBC të FEUT</i> <i>Dokumenti 130: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ndjekin rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik. Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti në bashkërendim me komisionin e përhershëm të sigurimit të cilësisë nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre</p>

<p>cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjerimet e marra nga këto grupe fokusi, ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjerimeve. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo vit. akademik nga përgjegjësi i departamentit. Vëtë Institucioni realizon pyetësor për të ditur mendimet dhe sygjerimet e stafit mësimdhënës si edhe atë ndihmës në lidhje me mësimdhënien.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve në shqip 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 81: Udhëzues mbi praktikat mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Format mikrotezë MSH</i></p> <p><i>Dokumenti 81.1: Programi i Praktikës Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Leksionet e hapura nga iektorë të ftuar të huaj dhe vendas të organizuara në FEUT, marrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore e organizuar me mbështetjen e stafit akademik, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Dokumenti 36: Të dhëna për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i></p> <p><i>Dokumenti 31-3: Publikime në WEB mbi mobilitetet për studentët</i></p> <p><i>Dokumenti 31-8: Publikimi në WEB i mundësive për punësim</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Proceeding COCEFKS.volumi 1</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1 -13: Botime në WEB në funksion të studentëve</i></p>

	<p><i>Dokumenti 31-12: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Dr. Kielce (Poloni)</i></p> <p><i>Dokumenti 31-13: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Prof.Asoc.Laguera</i></p> <p><i>Dokumenti 18-1: Silabuset e lëndëve të ofruara në 2021-2022 (anglisht)</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 124: Urdhër Nr.110 MAS dt. 4.03.2022 – Për mësimdhënien në gjuhën angleze të disa programeve të UT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të FEUT, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe Departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Dokumenti 36: Të dhëna për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Poroceeding COCEFKS.volumi 1</i></p> <p><i>Dokumenti 31-12: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Dr. Kielce (Poloni)</i></p> <p><i>Dokumenti 31-13: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Prof.Asoc.Laguera</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit dhe Departamentit të Menaxhimit, kualifikohet brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësime të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.</p>

<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimimit si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>FEUT ka një sërë marrëveshjes dhe parteritete me Institucione të Arsimit të Lartë në vend dhe jashtë duke zhvilluar herë pas here edhe leksione të hapura. Ky angazhim ka ndihmuar në rrjetizimin e universitetit dhe krijimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit me institucionet partnere</p> <p><i>Dokumenti 36: Të dhëna për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Poroceeding COCEFKS.volumi 1</i></p> <p><i>Dokumenti 31-12: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Dr. Kielce (Poloni)</i></p> <p><i>Dokumenti 31-13: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Prof.Asoc.Laguera</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimi</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së FEUT realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; - detyrave të kursit për problematikën e disiplinës; - provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës; <p>Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • puna në grup (10%) • aktivizimi dhe frekuentimi (10%) • detyra shtëpie (10%) • provimi semestral 10% • provimi final (60%). <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatuam se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e</p>

<p>metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës, studentët informohen rregullisht, në fillim të cdo semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabusat e cdo lënde dhe me kërkesat e programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Bazuar në rregulloret e studimeve të FEUT si edhe rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme të tilla si: vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, një kontroll ose vlerësim të pjesshëm si edhe vlerësimi përfundimtar. Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve (2021-2022)</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p>

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nëk përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit;

	<p>2. Vlerësimi përfundimtar;</p> <p>Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga vizita në Institucion, GVJ nuk evidentoi përdorim të ndonjë sistemi elektronik për testimin apo edhe vlerësimin. Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen pranë njësisë bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Komisionet e provimeve përbëhen së paku nga 2 anëtarë ku njëri prej tyre është pedagogu apo lektori i lëndës dhe tjetri asistenti ose një pedagog që ka të njëjtin profil ose të përafert</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit. Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për</p>


	<p>përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p> <p><i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas diplomimit të student</i></p> <p><i>Dokumenti 81: Udhëzues mbi praktikat mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Format mikrotezë MSH</i></p> <p><i>Dokumenti 31-14: Informacioni mbi panairin e punës;</i></p> <p><i>Dokumenti 31-6: Publikime në WEB mbi panairin e punës</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, Studentëve nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj. <i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Rezultatet e provimit i vihen në dispozicion sekretarisë mësimore brenda 7 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, e cila njofton studentët individualisht për rezultatin. Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, në takimin që pati me sekretarinë mësimore evidentoi se brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, studenti ka të drejtë të shohë provimin e korrigjuar apo të bëjë ankimum në rast se ka pretendime për rezultat më të lartë.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orëve). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas</p>

<p>përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimohe në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili ngre një komision <i>ad hoc</i>, në përbërje të të cilit janë edhe pedagogët e komisionit të provimit. Rezultati përfundimtar pas rivlerësimit i bëhet me dije studentit nga sekretaria mësimore, brenda një jave nga depozitimi i ankesës. Ky vendim i bashkëngjitet procesverbalit të provimit. Kjo është një procedurë por që për këtë program studimi, GVJ ju bë me dije se nuk ka patur raste ankimi për provimet.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.7</p> <p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore për gjerësinë dhe thellësinë e njohurive, metodologjive dhe aftësive që synon të përcjellë tek studentët, krijon jo vetëm mundësinë e thellimit në ekspertizën e tyre si menaxherë të niveleve të ndryshme, por zhvillon dhe elementë të menduarit kritik e analizës së thelluar të fenomeneve.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të programit të studimit dhe silabuseve vëren që një pjesë e lëndëve janë avancim i lëndëve të BA, ndërkohë një pjesë tjetër shërbejnë për të aftësuar studentët në lidhshmëri, në përdorimin e metodologjive për zgjidhjen e problemeve</p>



	<p>komplekse të biznesit dhe të organizatave. Përmes detyrave, projekteve dhe rasteve studimore, studentët aftësohen në zgjidhjen e problemeve konkrete, të punuarit në skuadër, të menduarit strategjik etj. Punimi i temës së diplomës është një tjetër element i rëndësishëm në formimin e kompetencave profesionale, sepse krahas aftësisë për të eksploruar, thelluar në literaturë, përdorimit të analizave të natyres cilësore dhe sasiore, kërkon interpretim të rezultateve, sintezë e deduksion në formulimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve, të aftëson në të shkruarin shkencor dhe të kalit durimin për punë të pavarur kërkimore.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar dosjes së plotë të programit të studimit të paraqitur në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se syllabuset e lëndës/modulit paraqesin qartë ne përmbajtjen e tyre: ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse, objektivat, aftësitë dhe kompetencat që priten të fitoje studenti.</p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacioni në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës</p> <p><i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët</p> <p><i>Dokumenti 31-12: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Dr. Kielce (Poloni)</i></p>




<p>teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p><i>Dokumenti 31-13: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Prof.Asoc.Laguera</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Projekte ndërkombëtare</i></p> <p><i>Dokumenti 31-12 dhe 13: Publikime në WEB të leksioneve të hapura me profesorë të huaj</i></p> <p><i>Dokumenti 31-1: Publikime në WEB të trajnime, punësime, mobilitete, etj.</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Atë synojnë që të krijojnë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. FEUT organizon Konferenca Studentore, ku studentët kanë marrë pjesë me punime shkencore të tyre, rezultat i mbështetjes së vazhdueshme që i jep personeli akademik.</p> <p><i>Dokumenti 31-14: Informacioni mbi panairin e punës;</i></p> <p><i>Dokumenti 31-6: Publikime në WEB mbi panairin e punës</i></p> <p><i>Dokumenti 30: Institucionet bashkëpunuese për MSHAB dhe praktikën</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga</p>	<p>Shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të Konferencës sponsorizohen nga Institucioni. Gjithashtu, në FEUT organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide inovative, dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik.</p>

studentët dhe i mbështet financiarisht ato.				
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur raste të studentëve master të këtij programi studimi, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka Institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Punimi i temës së diplomës është një tjetër element i rëndësishëm në formimin e kompetencave profesionale, sepse krahas aftësisë për të eksploruar, thelluar në literaturë, përdorimit të analizave të natyres cilësore dhe sasiore, kërkon interpretim të rezultateve, sintezë e deduksion në formulimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve, të aftëson në të shkruarin shkencor dhe të kalit durimin për punë të pavarur kërkimore. <i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 18: Silabuset e lëndëve shqip viti 2021-2022</i> <i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i> <i>Dokumenti 80.1: Formati i tezës së diplomës MSH viti 2022</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në Rregulloren e Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore neni 24 përcaktohet që diplomimi bëhet përmes mikrotezës që ka karakter kërkimor dhe aplikativ, mbështetur në Udhëzuesin për Temën e Diplomës. Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i mikrotezës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Departamenti ka përcaktuar gjithashtu një template (format) të

	<p>punimit të mikrotezës. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Gjatë vizitës në institucion një nga diskutimet me stafin e departamentit ishte si sigurohet origjinaliteti i mikrotezave. U dakordësuar që kjo mbetet një çështje shumë e diskutueshme, ku përtej aspekteve procedurale dhe të integritetit të pedagogut, e rëndësishme është kultura e institucionale në këtë drejtim.</p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzuesi i Temës së Diplomës</i> <i>Dokumenti 80.1. Format i punimit të mikrotezës</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas përcaktimeve në aktet rregullatore institucionale në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Studentët që vlerësohen me notë kaluese në mbrojtjen e diplomes mbyllin ciklin e dytë të studimeve sipas profilit respektiv. <i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i mikrotezës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Departamenti ka përcaktuar gjithashtu një template (format) të punimit të mikrotezës</p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzuesi i Temës së Diplomës</i> <i>Dokumenti 80.1. Format i punimit të mikrotezës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti angazhon personel akademik të kualifikuar me grada e tituj, eksperte të fushës për orientimin, përcaktimin dhe drejtimin e temave të diplomave për studentët. Në udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, janë të shprehur qartë procedurat që ndjek pedagogu udhëheqës në ndihmë të realizimit me sukses të temës së diplomës nga ana e studentit. Roli i udhëheqësit është kryesisht drejtues, keshillues dhe konsultues. Kontributi i udhëheqësit në realizimin e punimit fillon me saktësimin e temës deri në përfundimin e punimit. Udhëheqësi keshillon studentin për përcaktimin e strukturës së temës, nxjerrjen e grupçështjeve, trajtimin e problemeve teorike praktike, rekomandimin e literaturës, përcaktimin e afateve të</p>



	punes, kontrollin e realizimit te detyrave si dhe formulimin e nje teze te qendrueshme.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, janë të shprehur qartë procedurat që ndjek pedagogu udhëheqës në ndihmë të realizimit me sukses të temës së diplomës nga ana e studentit. Roli i udhëheqësit është kryesisht drejtues, keshillues dhe konsultues. Kontributi i udhëheqësit në realizimin e punimit fillon me saktësimin e temës deri në përfundimin e punimit. Udhëheqësi keshillon studentin për përcaktimin e strukturës së temës, nxjerrjen e grupçeshtjeve, trajtimin e problemeve teorike praktike, rekomandimin e literaturës, përcaktimin e afateve të punës, kontrollin e realizimit të detyrave si dhe formulimin e nje teze te qendrueshme.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Sipas përcaktimeve në aktet rregullatore institucionale në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë. Si rregull mbrojtja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Studentët që vlerësohen me notë kaluese në mbrojtjen e diplomes mbyllin ciklin e dytë të studimeve sipas profilit respektiv. <i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	FEUT mundëson pajisjen me diplomë të studentëve që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore si dhe detyrimet ndaj institucionit sipas rregullores së organizimit, kontratës së studimit dhe legjislacionit në fuqi. Studentët e MSHAB me dy profile Menaxhim dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore, në përfundim të studimeve, pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës titulluar: “Master i Shkencave në Administrim Biznesi” <i>Dokumenti 015: Modeli i diplomës</i> <i>Dokumenti 015: Suplementi i diplomës</i>
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit të programit të studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, bazuar në rregulloret dhe procedurat institucionale. Studenti depoziton një kërkesë pranë sekretarisë mësimore dhe brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë, i jepet një kopje e firmosur dhe



	vulosur e programit të ciklit të studimit dhe suplementit. <i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Sekretaria Mësimore, nëpërmjet zyrës së saj të pranimeve, ndërton dosjen e plotë personale në format fizik dhe elektronik të studentit, që menaxhohet nga personeli i Sekretarisë Mësimore nga viti në vit. Ajo përmban të dhënat e plota për studentin deri në diplomim dhe pas mbylljes së studimeve nga ana e tij, dosja arkivohet duke respektuar legjislacionin në fuqi. <i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit,	GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) ku specifikohet se informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Menaxhimit). Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, mblidhen dhe administrohen nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, e cila administron

<p>angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>dosjet e plota për çdo anëtar të personelit. Gjatë vizitës në zyrën e BNJ nuk u evidentuan mangësi në mos ruajtjen e dokumentacionit (diploma apo ekuivalentime) në original apo të noterizuar në dosjet respektive të të dhënave të personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Këto procedura paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kërkohet staf akademik me gradën shkencore Doktor, pra një nivel më lart se niveli i studimeve, Master i Shkencave. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme sic u verifikua nga tabelat e të dhënave në RVB. Bazuar në RVB, procesi i seleksionimit të kandidatëve kalon në disa faza, procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Gjatë vizitës në zyrën e BNJ u kërkua verifikimi për 2 rekrutimet më të fundit (PAE) të na vendosej në dispozicion dokumentacioni që ka shoqëruar gjithë këtë proces, dhe u korstatua se në dosjet respektive ishin ruajtur dokumentat e kërkua.</p> <p><i>Dokumenti 02: Statuti I UT</i></p> <p><i>Dokumenti 067: Procedure rekrutimi e stafit akademik te brendshem</i></p> <p><i>Dokumenti 068: Procedure rekrutimi e stafit akademik te jashtem</i></p> <p><i>Dokumenti 042: Permbajtja e dosjes se pedagogeve te jashtem-publikimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit. GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik pa grade shkencore nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ këshillon IAL se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e përbashkët të rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishin shumë të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me</p>

	nivelein e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi. <i>Dokumenti 042: Përmbajtja e dosjes se pedagogeve te jashtem-publikimi</i>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Sipas GVB procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një Kërkesë për Rekrutim Stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kriteret që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen te rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në web faqen e Institucionit por sipas tyre edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në vend kushtet e punës dhe mjedisin që i mundësonte personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Mjediset e Institucionit gjenden në një vendndodhje të mirë në qytetin e Tiranës, lehtësisht të aksesueshme. Zyrat ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të

<p>personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>nevojshme dhe të gjitha ambientet e Institucionit mbuloreshin nga rrjeti eireless që ofronte Internet për stafin dhe studentët.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Organizimit të Programit të Studimit MSHAB 2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në dokumentat bazë (Plani Strategjik i Zhvillimit, Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi), përmenden synime dhe objektiva të mirëfilla të Institucionit për përmirësimin e stafit akademik. Sipas RVB dhe evidencave (tabelat 19 dhe 20) mund të konstatojmë se kërkimi shkencor i stafit, si edhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes Institucionit dhe partnerëve të rëndësishëm akademikë dhe të biznesit, tregojnë se FEUT aktualisht është në drejtimin e duhur për aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime shkencore. Gjithashtu, nga intervistat me përgjegjës të departamentit, Zv.Dekanin dhe stafin akademik, GVJ u informua se përparësi në financim kanë personat që mbrojnë doktoraturën, dhe si lehtësim mund të kenë reduktim oresh, ose edhe financime për pjesëmarrje në konferenca shkencore.</p> <p><i>Dokumenti 36: Të dhëna për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti i UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe Përgjegjës të Departamentit të Ekonomisë GVJ konstatoi se Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe së fundmi edhe në kuadrin e përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies. Bien në sy trajnime për përdorimin e platformës së mësimin online G Suite dhe sistemet “Student Management System”. Plani i trajnimeve për stafin akademik hartohet në fillim të vitit akademik dhe të pyetur mbi nivelin e zbatueshmërisë së tij, stafi u shpreh se ishin trajnuar nga Institucioni.</p> <p><i>Dokumenti 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit UT</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Poroceeding COCEFKS.volumi 1</i></p> <p><i>Dokumenti 31-12: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Dr. Kielce (Poloni)</i></p>

	<p><i>Dokumenti 31-13: Workshop i organizuar nga departamenti i menaxhimit me Prof.Asoc.Laguera</i></p> <p><i>Dokumenti 33: Raporti analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimi</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1 dhe 2 në evidencën 18: “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit”) si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të këtij programi, duke përbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit.</p> <p>Në vitin 2019-2020 janë angazhuar në mësimdhënie 14 pedagogë të brendshëm dhe 1 pedagog i jashtëm, nga të cilët: 7 Prof.Dr. 4 Prof.Asoc; 2 Dr; 1 PhD cand dhe 1 Msc.</p> <p>Ndërsa në drejtimin e punimeve të diplomës janë angazhuar për vitin 2021-2022 – 22 pedagogë; për vitin 2020-2021 - 22 pedagogë dhe për vitin 2019-2020 – 22 pedagogë, nga të cilët në dy vite është angazhuar dhe 1 pedagog Msc.</p> <p>Sipas GVB, ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj tek PAE dhe PAK dëshmon për një angazhim të personelit akademik për plotësimin e objektivave të programit të studimit në MSHAB</p> <p><i>Dokumenti 22: Të dhëna mbi personelin të përfshirë në program</i></p> <p><i>Dokumenti 23: Të dhëna tabelore mbi personelin e njësisë bazë</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Të dhëna për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i plotë</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se FEUT e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj. Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, 1 sallë interneti, 1 sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedisë të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore në FEUT ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit ka në dispozicion laboratorë informatike (Tabela 16, evidenca 18). Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale si: Alpha dhe Financa 5, SPSS apo programi i Business English, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni listohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me institucione të tjera. Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, në <i>evidencën 19</i>, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përvec anës teorike të mësojnë dhe anën praktike. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e FEUT për praktikat e tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas verifikimeve të dokumentacionit (tabela 16 në RVB) të kryera nga GVJ, Institucioni raporton se disponon salla për biblioteka. Këto salla, sic u konstatua në vend, në fakt ishin ambiente të përshtatshme për lexim e studim, por bibliotekë e mirëfilltë ishte vetëm një hapësirë kryesore e vetme. GVJ gjatë vizitës në Institucion, konstatoi se salla e Bibliotekës ishte e pajisur me ndricim natyral, me sistem ngrohje/ftohje, me raftë, rreth 200 poste pune në total, 11 poste me kompjutera, dhe orari i funksionimit ishte 8.30 – 19.30. Kjo sallë është në dispozicion të të gjithë studentëve të FEUT.</p> <p><i>Dokumenti 125: Bibliotekat ne Ut dhe sistemet e informacionit</i> <i>Dokumenti 120: Te dhena per biblioteken</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në Bibliotekat e Institucionit mund të gjenden fizikisht gjithsej 5280 tituj librash. Tekstet në bibliotekë janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, kryesisht atë angleze. Gjatë vizitës në</p>

<p>apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Institucion, GVJ konstatoi tituj në bibliotekë të cilët janë të shumte.</p> <p><i>GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e tyre, pavarësisht se për këtë program studimi mund të përdoren libra dhe literaturë online e cila gjendet me bollëk në librarine elektronike jstore.</i></p> <p><i>Dokumenti 125: Bibliotekat në Ut dhe sistemet e informacionit</i></p> <p><i>Dokumenti 120: Te dhena për bibliotekën</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në bibliotekën online JSORE, ku FEUT ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 85.000 tituj librash. Ky fond librash, bashke me ato që ofron Edward Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, janë në dispozicion të personelit dhe studentëve të FEUT pa pagesë, në funksion të punës mesimore dhe shkencore sipas fushave të interesit.</p> <p><i>Dokumenti 125: Bibliotekat në UT dhe sistemet e informacionit</i></p> <p><i>Dokumenti 120: Te dhena për bibliotekën</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesit në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të FEUT.</p> <p>Kjo bibliotekë kishte vetëm 11 poste kompjuterike GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë.</p> <p><i>Sugjerohet shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter deklarohet se FEUT angazhohet në nxitjen e njësive kryesore dhe njësive bazë që çdo vit të paraqesin kërkesat e tyre për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që secila prej tyre ofron. Një pjesë e titujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë edhe botime të personelit akademik të Institucionit. Në DVV, nga ana e GVJ nuk u konstatua asnjë plan konkret apo qoftë edhe model kërkese për shtimin e titujve të rinj në bibliotekë. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik u shpreh se kërkesat e pedagogëve për tekste të reja mbledhen nga shefi i departamentit i cili ia percjell dekanit dhe ky administratorit.</p>

	<p>Pedagogët u shprehën se kanë mundësi të kenë tekstet e duhura dhe në kohë. Meqënëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument që vërteton ekzistencën dhe për më tepër implementimin e një plani të detajuar të pasurimit të zërave të bibliotekës.</p> <p><i>GVJ sugjeron hartimin e një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi.</i></p> <p><i>Dokumenti 125: Bibliotekat ne Ut dhe sistemet e informacionit</i></p> <p><i>Dokumenti 120: Te dhena per biblioteken</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Salla e Bibiotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 19.30. Ajo qendron e hapur ne fundjave per sezonin e provimeve. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me</p>	<p>Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore si pjesë e njësisë së Administratës të FEUT, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm</p>

<p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës. Gjatë vizitës në sekretarinë e studimeve master, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, rregjistrat, proces-verbalet, rregjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe. Sistemi ka akses të dedikuar dhe të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit.</p> <p>Sic u informuam gjatë vizitës në Institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroheshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit. Sistemi SMS përdorej gjerësisht edhe nga ana e stafit administrativ. Të dhënat mund të përditësohen elektronikisht, përveçse mbahen në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Ndërsa, të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar) dhe të gjitha regjistrat në formë të shkruar dhe në version elektronik, janë në administrimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>Ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemit digjital të menaxhimit të informacionit jo vetëm për sekretarinë, por dhe të gjithë sistemin e FEUT mbetet një sfidë e qenësishme për të.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar RVB, strukturat përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të personelit akademik e ndihmës akademik janë Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshiva.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse referohet në RVB të përgatitur nga Institucioni dhe sic edhe u confirmua gjatë vizitës në Institucion, nga ana e GVJ, sistemi SMS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele aksesit: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i dedikuar për studentët. Nëpërmjet sistemit SMS, stafi akademik mund të</p>

	realizojë shumë funksione të ofruara nga modulet e ndryshme të sistemit, si psh., modifikojë të dhënat personale në modulën „profili im“, të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave dhe të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për cdo lëndë, etj.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi i FEUT mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave personale të emailit. Më shumë informacion në lidhje me sistemin, GVJ mori gjatë vizitës në Institucion. Gjithashtu, u konstatua se për të menaxhuar në mënyrë sa më efektive procesin mësimor online, gjatë vitit akademik 2020-2021 Institucioni implementoi edhe platformën G Suite me komponentët Google Classroom dhe Google Meet. Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua se kjo platformë ishte e llojit: “academic account” duke ofruar facilitate të konsiderueshme për pjesëmarrësit.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit të studentëve në FEUT është një sistem që mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mëimit nga ana e studentëve dhe e stafit. Kjo referohet në RVB të përgatitur nga institucioni por konstatohet edhe në evidencën “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”. Megjithatë, sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion sistemi nuk mundësonte gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre që kanë të bëjnë me mësimdhënien.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it të universitetit (sipas disa referencave në links më poshtë). GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për shumë prej tyre mungon një bio e shkurtër prezantuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorzuar në DVV, UT përcakton në Statutin pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare (<i>Evidenca 2, "Statuti i UT", nenet, 24, 45</i>).</p> <p>Sipas statutit buxheti hartohet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, Planin Strategjik të Institucionit dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit i UT dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Evidencë për informacione financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të dhënave financiare institucionale (evidenca 17), dhe në (tabelën 18 në evidencën 8). Vlen të theksohet se informacioni i përfshirë në këto dy evidenca është shumë i përmbledhur në rang institucional dhe në asnjë moment nuk i referohet vetëm programit të studimit në fjalë. Vec kësaj, në asnjë nga këto evidenca nuk u gjetën informacione në lidhje me kostot specifike të programit të studimit; apo informacion për pasurimin e bibliotekës, etj.</p> <p><i>Dokumenti 02: Statuti I UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare</p>	<p>Sipas RVB, auditimi i gjendjes së financimit dhe efektiviteti financiar të institucionit përveç organizmave të auditit të KLSH dhe MAS, ka dhe sektorin e auditit të brendshëm nën varësinë e Bordit të Administrimit i cili kryen në mënyrë periodike auditimin dhe raporton përpara Bordit të Administrimit.</p> <p><i>Dokumenti 150-1_Miratim i Planit Strategjik te Auditimit, 2021-2023</i></p>

për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<p>Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u mbështet në analizën e RVB dhe tabelave mbështetëse të saj, si edhe dokumentacionit shoqërues, pjesë e DVV.</p> <p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni, kontrolli buxhetor realizohet nga Administratori dhe synon të garantojë përdorimin eficient të burimeve të Universitetit, në funksion të arritjes së objektivave të tij. Sipas DVV, detyrë e Administratorit është pikërisht ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të çdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare. Në vijim të analizës së shkallës së përmbushjes së këtij kriteri, nga shqyrtimi i (tabelës 18 në evidencën 8), GVJ konfirmon se Institucioni ka paraqitur nja plan financiar institucional. <i>Dokumenti 02: Statuti I UT</i></p> <p><i>Këto evidenca nuk specifikojnë ndërhyrjet e posaçme apo diversifikimin e financimit të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Elemente të tilla nuk i ndeshëm as në evidencën "Analizë Vjetore e FEUT".</i></p>

Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>Me miratimin e buxhetit nga Bordi i Administrimit, si një përmbledhje e harmonizuar e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e të gjithë strukturave të universitetit në mbështetje të plotë të nevojave të gjithanshme për realizimin e misionit dhe objektivave të universitetit në tërësi dhe programeve të studimit në veçanti, garantohej qëndrueshmëria financiare e gjithë periudhës së zhvillimit të programit të studimit.</p> <p><i>Dokumenti 47: Te dhena nga Raporti financiar vjetor</i> <i>Dokumenti 48: Te dhena nga plani financiar I programit</i></p>
--	--


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Administrim-Biznes me profile në Menaxhim dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore, me 120 ECTS është konceptuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015 dhe VKM Nr 41 dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të, si dhe një sërë dokumentash ligjorë dhe rregullatorë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti UT; - Rregullorja e UT; - Rregullorja e FEUT; - Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit; - Rregullorja e Programit të Studimit; <p>Të gjitha këto akte mbulojnë të gjithë veprimtarinë e punës së njësisë kryesore dhe bazë nga hyrja e studentëve në programin master, deri në diplomimin e tyre. Departamenti si rregull propozon tek Dekani kriteret e pranimit të studentëve në MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, nisur nga kriteret ligjore dhe kritere shtesë që departamenti i konsideron të rëndësishme, ku prioritet merr mesatarja e studimeve BA dhe programet ekonomike të studimit në BA.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët që nga momenti i hyrjes deri në dalje nga studimet gëzojnë të drejtën të trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë elementët dhe strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe bazë të programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, të marrin pjesë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret në një sërë organesh kolegjiale nga Senati, në proceset e akreditimit përmes pjesëmarrjes në grupet e Vlerësimit të Brendshëm, në Këshillin e Etikës, etj.</p> <p>Studentët janë pjesë e Bordit të Administrimit, gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për trupën drejtuese të departamenteve /</p>

	<p>fakulteteve dhe universitetit si dhe përzgjidhen përmes votës së shokëve të tyre në Qeverinë Studentore dhe Këshillat Studentorë.</p> <p>Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën të përfitojnë bursa studimi, bursa Erasmus, të përfshihen në projekte, të marrin pjesë në aktivitete e seminare extracurriculare, etj.</p> <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr 41, dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT përditësuar 2016</i></p> <p><i>Dokumenti 6: Rregullore për funksionimin e Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Programit të studimit MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 71: Kriteret e propozuara të pranimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti Ekonomisë bëjnë të aksesueshme në faqet e tyre zyrtare në internet të gjithë informacionin që ndihmon të gjithë të interesuarit (aplikantët për studime dhe studentët aktuale) për të marrë vendime dhe kuptuar proceset. Krahas informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet rregullatore të universitetit dhe fakultetit, që ndihmojnë studentët për të kuptuar gjithë procesin nga aplikimi, përzgjedhja, regjistrimi, transferimi dhe njohja e krediteve, diplomimi, në WEB gjenden programet e studimit, departamentet, stafi akademik dhe shumë informacione të tjera përfshirë dhe email e kontaktit të pedagogëve.</p> <p>Në këtë link të WEB https://feut.edu.al/studentet studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme për jetën e tyre studentore, si dhe shumë nga procedurat, formularët për praktikën dhe diplomën. Ndërsa në këtë link gjejnë https://feut.edu.al/programet-studimi/master/master-shkencor kushtet e pranimit në MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, programin, vlerësimin dhe disa elementë të tjerë të rregullores së programit të studimit. Në lidhje me stafin e departamentit gjejnë të gjithë informacionin në linkun</p> <p>https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-manaxhimit/stafi-i-departamentit-manaxhim</p> <p><i>Fakulteti Ekonomisë për madhësinë dhe cilësinë e të gjithë punës që bën, do të duhej të ndërtonte dhe Learning Management</i></p>





	<p><i>System, i cili do ta ngrinte në një nivel shumë më të mirë bashkëveprimin me studentët dhe kënaqësinë e tyre gjithashtu.</i></p> <p>Në WEB, Departamenti i Menaxhimit përgjegjës për programin MSHAB publikon të gjitha thirrjet në interes dhe për studentët. Një dokument tjetër i rëndësishëm për orientimin e kandidatëve që duan të studjojnë në FEUT është Guida e Studentit.</p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1 deri 14 : Publikime në WEB për studentët</i></p> <p><i>Dokumenti 105: Guida e Fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve në MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, bazohen kryesisht më Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në Statutin e UT. Departamenti i Menaxhimit formulon në muajin Dhjetor deri më dt. 10 kriteret shtesë dhe kuotat e pranimit. Fakulteti i miraton dhe më pas deri më dt. 20 Dhjetor Senati UT i miraton dhe bën propozimin e tij për MAS. Kriteret shtesë që Departamenti propozon kanë të bëjnë kryesisht me preferencën e studentëve që kanë përfunduar studimet bachelor në fakultete ekonomie (përparësi marrin studentët e FEUT), përfshirë dhe ata që kanë studjuar agro-biznes, si dhe mesatarja e studimeve bachelor.</p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti i UT</i></p> <p><i>Dokumenti 71: Kriteret e propozuara të pranimit të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 72: Kuotat e pranimit të propozuara për dy vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Faqja e internetit të FEUT ka të gjithë informacionin e duhur për procesin e rekrutimit të studentëve në MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore. Gjithashtu, Fakulteti Ekonomisë prodhon dhe vë në dispozicion të publikut dhe material të tjera të cilat japin informacion mbi programet, procedurat, aplikimin, rregulloren e programit etj.</p> <p>Gjithashtu, nisur nga prioriteti që studentët e FEUT kanë në përzgjedhje, në fund të vitit të tretë të BA, drejtuesja e departamentit dhe një pjesë e stafit të tij takojnë në mënyrë të grupuar studentët dhe bashkëbisedimi me ta vlen për t'i adresuar sa më mirë interesat e tyre në studimet master, për të vlerësuar elementë të përvojës së tyre në bachelor dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme procesin mësimor të departamentit.</p> <p><i>Dokumenti 105: Guida e Fakultetit</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në Rregulloren e UT dhe në Rregulloren e Programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, pasqyrohen procedurat e përparimit akademik. Në nenin 22 të Rregullores së Programit të Studimit, përcaktohen elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve dhe pesha që zë provimi ndërmjetëm dhe përfundimtar. Studenti është kalues nëse ai ka mbledhur 50% të pikëve në provimin ndërmjetës dhe atë përfundimtar.</p> <p>Në Nenin 52 të Rregullores së UT përcaktohen kriteret e kalimit nga viti I në të II, ndërsa në nenin 53 numri i riprovimeve që studenti ka të drejtë të hyjë. Gjithashtu, në Rregulloren e UT, Neni 71, 72 dhe 73 i referohen procedurës së ndërprerjes së studimeve nisur nga arsytet për ndërprerjen e studimeve, autoriteti që ka të drejtën e miratimit, gjithashtu qartësohet si bëhet përditësimi i dijeve të studentit pasi ai rikthehet për të vijuar studimet. Bazuar në Statutin e UT, Rregulloren e UT, Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë. Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në WEB e FEUT, në Guidën e FEUT dhe nga çdo pedagog në javën e parë, por dhe më pas në mësim në përputhje me silabuset e lëndëve.</p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT përditësuar 2016</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Programit të studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 115: Guida FEUT</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 18 deri 18.3 – Silabuset e lëndëve</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Një nga përfitimet më të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, është mobiliteti studentëve brenda dhe jashtë vendit. UT bazuar dhe në Ligjin Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në Statutin e tij përkatësisht Neni 109 dhe 112 ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe të transferimit të tyre nga një institucion i arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Në Rregulloren e Universitetit në kapitull 3 të emërtuar “Ekuivalentimi, tranferimet dhe ndryshimi i sistemit të studimeve” përmes një numri nenesh përcaktohen dhe qartësohen: Ekuivalentimi; Lloji i transferimeve; Procedura e Kërkesës, Propozimi dhe Miratimi i Transferimit; Ekuivalentimi.</p> <p>Si rregull, Drejtuesi i departamentit përcakton komisionin e ekuivalentimit i cili shqyrton të gjitha kërkesat që vijnë qoftë për transferimet, programe të dytë studimi apo është një kërkesë ligjore në kuadër të njohjes së diplomave të huaja</p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT përditësuar 2016</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Neni 22 “Mbi kontrollin e dijeve dhe instrumentat e vlerësimit” përcaktohen të gjitha modalitetet e vlerësimit të vazhduar, nga detyrat e kursit, detyrat e shtëpisë, provim i ndërmjetëm dhe provim përfundimtar, si dhe elementë proceduralë që kanë të bëjnë me të drejtën e studentëve për të hyrë në provim dhe për t’u ankimuar në lidhje me rezultatin. Gjithashtu, në silabuset e çdo lëndë jepet mënyra e kontrollit të dijeve dhe si rregull në orën e parë të çdo lëndë pedagogu qartëson studentët për mënyrën e vlerësimit. Natyrisht, eksperiencia është e tillë që dhe në periudhat ndërmjetëse që lidhen me afatet e dorëzimit të detyrave apo para provimeve studentët rikujtohen për rregullat, procedurat, kufizimet dhe të drejtat e tyre.</p> <p><i>Përtej punës së bërë nga pedagogët, informacioni do të ishte më lehtë i aksesueshëm nëse Fakulteti do të kishte një sistem LMS, ku në çdo lëndë do të kishin mundësi të kishin silabusin dhe rregulloren e programit, si kalendar të të gjitha veprimtarive brenda lëndës.</i></p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Programit të studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 18 deri 18.3 – Silabuset e lëndëve</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit neni 24 përcaktohet që diplomimi bëhet përmes mikrotezës që ka karakter kërkimor dhe aplikativ, mbështetur në Udhëzuesin për Temën e Diplomës.</p> <p>Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i mikrotezës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Departamenti ka përcaktuar gjithashtu një template (format) të punimit të mikrotezës. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Gjatë vizitës në institucion një nga diskutimet me stafin e departamentit ishte si sigurohet origjinaliteti i mikrotezave. U dakordësuam që kjo mbetet një çështje shumë e diskutueshme, ku përtej aspekteve procedurale dhe të integritetit të pedagogut, e rëndësishme është kultura e institucionale në këtë drejtim.</p> <p><i>Dokumenti 7-1: Rregullore e Programit të studimit MSHAB 2022</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzuesi i Temës së Diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1. Format i punimit të mikrotezës</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Ka tre rrugë të informimit të aplikantëve për studimet mastër në MSHAB, me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - E para përmes WEB të UT, bazuar në politika të caktuara të marketingut që universiteti ka të përcaktuara në Statutin e tij; - Së dyti, Departamenti i Menaxhimit ka të formulur një dokument mbi “Politikat e marketingut të programit të studimit” ku identifikohen disa rrugë nga bursat, tek panairët, këshillimi i karrierës, konkurset, mbështetja e sipërmarrjes së studentëve. Gjatë vizitës në institucion, drejtuesja e departamentit u shpreh që departamenti bën seanca informuese me studentët e BA të FEUT, kryesisht të atyre që studojnë BA në menaxhim; - Rruga e tretë është përmes Zyrës së Karrierës, e cila po strukturohet dhe ka marrë një vemendje më të rritur në institucion pas pandemisë, ku me rsistrukturimin e godinës ka zënë një vend të dukshëm në hyrje dhe ka një specialiste të dedikuar në raportet me studentët; <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 49: Politikat e marketingut të programit të studimit</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore. Fillimisht është WEB i fakultetit dhe Guida e Fakultetit Ekonomik ku studentët gjejnë informacionin paraprak dhe bazë. Dosja e plotë e programit të studimit është një dokument i formuluar me seriozitet, në të cilin gjendet çdo informacion i nevojshëm në lidhje me programin MSHAB, me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore. Programi përmban 120 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve më zgjedhje për të dyja profilet e studimit; praktikën mësimore dhe detyrimin përmblyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 4 semestra, çdo semestër përmban 30 ECTS dhe zgjat 15 javë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, studentët gëzojnë të drejtën të përfundojnë studimin në MSH në një afat ligjor që është dyfishi i periudhës së studimit, kuptuar deri në 4 vite nga momenti i nisjes, përjashtim nga ky rregull bëhet në rastin kur student pezullon studimet e tij për një afat të caktuar kohor për rrethana të caktuara në jetën e tij. Departamenti bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit përcakton dhe koordinatorin e programit, i cili në thelbin e veprimtarisë së tij është një ndërlidhës i rëndësishëm i studentit me departamentin dhe gjithë procesin akademik. Gjatë vizitës në institucion evidentuam që Sekretaria e studimeve master është e organizuar veçmas nga sekretaria e bachelorit, Gjithashtu, në përputhje me Statutin e UT</p>

	<p>dhe Rregulloren e UT, Sekretaria mësimore dhe Zyra e Informacionit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre.</p> <p>Funksionalizimi i sistemit të ri të sekretarisë do të shënonte një hap cilësor në raportet e përditshme student-pedagog-sekretari-drejtim FEUT. <i>Mbetet e rëndësishme ndërtimi dhe i një sistemi LMS.</i></p> <p><i>Dokumenti 115: Guida e Fakultetit Ekonomik</i></p> <p><i>Dokumenti 18 deri 18.3 – Sillabuset e lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 7.1. Rregullore e Programit të Studimit MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore e UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nëse flitet për pikat e forta të FEUT janë cilësia dhe reputacioni i stafit akademik si dhe cilësia e studentëve, për rrjedhojë kanali më i rëndësishëm për punësimin e studentëve mbetet rekomandimi i tyre nga pedagogët, për shkak të networkut të tyre. Kjo gjë u diskutua dhe me stafin akademik të Departamentit të Menaxhimit gjatë vizitës në institucion</p> <p>Në FEUT, Qendra e Karrierës përbën një bërthamë të kontaktit të studentëve me tregun e punës, dhe ekzistojnë të gjitha premiset që ajo të rritet e bëhet më dinamike në kushtet që marrëdhëniet për sipërmarrjen kanë tashmë një zvdekë në fakultet. Gjatë vizitës në FEUT, Zv.Dekani për sipërmarrjen dhe specialistja e Qendrës së Karrierës evidentuan dhe punën e bërë gjatë vitit 2021-2022 në lidhje me Panairin e Punës, ku morën pjesë mbi 70 kompani të rëndësishme në vend. Gjithashtu në WEB e FEUT, botohen një sërë publikimesh që kanë lidhje me konkurse, intershipe, punësime etj në ndihmë dhe në shërbim të studentëve. Duhet theksuar që studentët e programit MSHAB përfshihen në aktivitete që organizohen nga departamenti, fakulteti por dhe UT.</p> <p><i>Dokumenti 12.1: Raport mbi qendrën e karrierës</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1 -14: Publikime në WEB të aktiviteteve, paanirit të punës, praktikave, intershipeve, konkurseve, etj</i></p>


<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni në funksion të studentëve vihet në shërbim të studentëve kryesisht përmes kanaleve të mëposhtme të komunikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - WEB i UT; - WEB i FEUT; - Pedagogëve; - stendës së FEUT në hyrje të fakultetit; - koordinatorit të programit; - sekretarisë mësimore; 			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Mësimi online për shkak të pandemisë, krijojë dhe një mënyrë tjetër të komunikimit pedagog-studentë përmes sistemit MS Teams, i cili mundësoi jo vetëm mësimin online, por dhe komunikimin e informacioneve, depozitimin e materialeve të ndryshme didaktike nga pedagogët por dhe upload-imin materialeve, detyrave etj nga studentët.</p> <p><i>Dokumenti 105: Manual i përdorimit të MS Teams;</i></p> <p><i>Dokumenti 137: Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë</i></p> <p><i>Dokumenti 44.2. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit- student.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Fakulteti është duke e përditësuar sistemin e menaxhimit të informacionit, siç edhe shprehen në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Gjatë vizitës në institucion nuk mundëm të shikonim si në përditshmëri kryhet komunikimi, studentët marrin informacionet që ju duhen, si aksesojnë pedagogët e si komunikojnë me studentët.</p> <p><i>Dokumenti 0: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit

të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UT çdo fakultet ka brenda njësisë së administratës, Sekretarinë Mësimore. Sekretaria Mësimore funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, mbi këtë bazë njësia kryesore ka formuluar Rregulloren e Sekretarisë për FEUT, që në setin e dokumentave të vendosura në platformën e ASCAL vjen si projekt-rregullore. Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS.</p> <p>Mbështetur në DVV dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është:</p> <table border="1" data-bbox="566 947 1361 1249"> <thead> <tr> <th>Emri i rprogramit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Studentë të regjistruar</th> <th>Nota mesatare ne hyrja</th> <th>Studentë të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Msc në Administrim Biznesi</td> <td>2019-2020</td> <td>38</td> <td>7.2</td> <td>45</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>50</td> <td>6.9</td> <td>42</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>39</td> <td>7.1</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Emri i rprogramit	Viti Akademik	Studentë të regjistruar	Nota mesatare ne hyrja	Studentë të diplomuar	Msc në Administrim Biznesi	2019-2020	38	7.2	45	2020-2021	50	6.9	42	2021-2022	39	7.1	-
Emri i rprogramit	Viti Akademik	Studentë të regjistruar	Nota mesatare ne hyrja	Studentë të diplomuar															
Msc në Administrim Biznesi	2019-2020	38	7.2	45															
	2020-2021	50	6.9	42															
	2021-2022	39	7.1	-															
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Përmes të dhënave të marra nga sekretaria, drejtuesja e departamentit ka hartuar për vitin 2020-2021 një raport analitik të detajuar, ku krahas të tjerave është bërë dhe një analizë e kalueshmërisë për lëndë dhe notës mesatare. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë e programeve master. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, regjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike në database excel, pasi sistemi i menaxhimit të informacionit të UT është në proces përmirësimi.</p>																		
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga</p>	<p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i> <i>Dokumenti 9: Projekt rregullore e sekretarisë mësimore;</i></p>																		



<p>pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p><i>Dokumenti 26: Të dhëna mbi studentët e rregjistruar, diplomuar, nota në hyrje, të larguar, të transferuar.</i></p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza vjetore e departamentit 2020-2021</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i FEUT</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore si pjesë e njësisë së Administratës të FEUT, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës. Gjatë vizitës në sekretarinë e studimeve master, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, rregjistrat, proces-verbalet, rregjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Fakulteti Ekonomik i UT, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore. Raportet vjetore kanë një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi.</p> <p>Një Raport tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit, në të cilën gjenden të dhëna mbi kalueshmërinë dhe mesataren e vlerësimit për çdo lëndë të departamentit, lëndët e MSHAB përfshirë. Një raport me vlerë në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur është ai i gjurmimit të studentëve pas diplomimit, të dhënat e të cilit duhet të shërbëjnë dhe për të përditësuar programin.</p> <p><i>Dokumenti 36: Analiza vjetore e departamentit 2020-2021</i></p> <p><i>Dokumenti 102: Raporti vjetor i FEUT 2020-21</i></p> <p><i>Dokumenti 101: Raporti vjetor i FEUT 2019-20</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim mbi tregun e punës pas diplomimit të studentëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Kreu IX i Statutit të UT i dedikohet studentëve, në Nenin 125- Të drejtat e studentëve- përcaktohet që studentët gjatë periudhës së studimeve kanë të drejtë të përfaqësohen në organet e UT, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe. Bazuar në Nenin 30 të Statutit të UT, në Senatin Akademik bëjnë pjesë dhe studentët, përfaqësuesit e të cilëve zgjidhen përmes votimit të studentëve. Bazuar po në Statut - Neni 32, nga 35 anëtarë që ka senati akademik 4 prej tyre janë studentë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjithashtu, studentët janë pjesë e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë; -komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët; - komisionit të kurrikulave; - komisionit të etikës; -grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc që mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë;
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë <i>Këshillat e Studentëve</i> të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.</p> <p>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret dhe organet e institucionit si: Rregullorja e UT; Rregullore e Komisionit të Kurrikulave; Rregullore për Zgjedhjen e Këshillit Studentor; NJSBC në rang fakulteti, etj sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimmarrje.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në Komisionin e Kurrikulave, në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e</p>

	<p>programeve, MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore përfshirë.</p> <p>Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.</p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT</i></p> <p><i>Dokumenti 103.2: Komisionet e përhershme të UT dhe këshilli etikës;</i></p> <p><i>Dokumenti 100: Rregullore për zgjedhjen e Këshillave Studentorë</i></p> <p><i>Dokumenti 38: Vlerësimi i lëndës nga studentë</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit MSHAB, me profil në menaxhim dhe menaxhim burimesh njerëzore është hartuar duke respektuar VKM 41, 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të”.</p> <p>Mbi këtë bazë, programi ka 120 kredite, zhvillohet në 4 semestra, çdo semestër ka 30 ECTS. Ngarkesa totale e programit është 3000 orë, nga të cilat 1350 orë në auditor, ngarkesa javore në auditor 20-24 orë. Njohja e studimeve të plota dhe të pjesshme bëhet përmes një procedure e cila bazohet në Statutin dhe në Rregulloren e UT, drejtohet dhe administrohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Mobiliteti i studentëve si një nga benefitet më të mëdha të Procesit të Bolonjës, gjen zbatim plotësisht në UT, në lëvizjen e studentëve nga një universitet në tjetër brenda dhe jashtë vendit, ashtu sikurse në njohjen e krediteve për programet e dyta të studimit, apo në programe të përfaërta brenda të njëjtës fushë studimi.</p> <p><i>Dokumenti 146: VKM 41, 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të”</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e plotë e programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT, në Rregulloren e Programit të Studimit studentët gëzojnë të drejtën e ankimimit të rezultatit pasi</p>

<p>ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>kanë dalë vlerësimi. Gjatë vizitës në institucion studentët shprehen se mundësia ekziston, gjatë mësimit online për shkak të komunikimit përmes platformës TEAMS ka qenë shumë më e thjeshtë rishikimi, reflektimi mbi vlerësimin e bërë nga pedagogu.</p> <p>Në mësimin normal, vlerësimet paraqiten në këndin e njoftimeve dhe nëse studentët nuk arrijnë ta shohin në kohë, ata humbasin afatin e përcaktuar nga rregullorja, <i>prandaj bëhet i domosdoshëm digjitalizimi i gjithë komunikimi me studentët.</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT</i></p> <p><i>Dokumenti 7.1: Rregullore e organizimit të programit të studimit MSHAB</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Një nga pikat më të forta të programit të studimit MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore, është stafi akademik i angazhuar në realizimin e tij, pjesë e Departamentit të Menaxhimit, gjë që e dëshmon dhe raporti mbi aktivitetin shkencor të njësisë bazë.</p> <p>Nëse do t'i referoheshim CV të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie dhe atij të angazhuar në diploma, do të evidentonim përfshirjen e tyre në konferenca ndërkombëtare dhe në botime prestigjioze. Në traditën e FEUT, një herë në dy vite organizohet një konferencë ndërkombëtare, e cila merr gjithë vëmendjen e duhur nga drejtuesit e fakultetit dhe stafi akademik në respektimin e standardeve që e bëjnë ndërkombëtare një konferencë. Për më tepër, pjesëmarrja dhe botimi i punimit të plotë mbështetet nga fondet e FEUT për kërkimin.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në IAL një pjesë e diskutimit u fokusua dhe në punën e kryer në drejtim të kërkimit shkencor. Nisur nga</p>

	<p>madhësia e fakultetit në strukturën e organizimit ka një Zv.Dekan për sigurimin e cilësië, kërkimin dhe ndërkombëtarizimin dhe një tjetër për gradat dhe titujt shkencorë që dëshmon dhe rëndësinë e peshën e dhënë në drejtim të aktiviteteve që lidhen me kërkimin.</p> <p>UT në planet e saj ka botimin e një reviste shkencore, <u>GVJ sugjeron që FEUT ka të gjithë kapacitetin njerëzor për të botuar një revistë periodike shkencore dhe për ta bërë atë të rankueshme.</u></p> <p><i>Dokumenti 5: Aktivitetin shkencor të njësisë bazë.</i></p> <p><i>Dokumenti 19: CV e stafit të programit;</i></p> <p><i>Dokumenti 62: Proceeding COCEFKS vol 1</i></p> <p><i>Dokumenti 87: Propozim për ngritje të strukturës botuese të UT</i></p> <p><i>Dokumenti 96: Grant për prezantim në konferenca dhe botime</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Marrëveshjet e lidhura nga UT me IAL të huaja, në pjesën më të madhe të tyre përfshijnë FEUT ose burojnë kryesisht prej tij. Në total për UT janë 79 marrëveshje të nënshkruara. Nga pikëpamja e raportimit të kriteret 2, duhet të evidentojmë që FEUT është i përfshirë në një numër projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare. Momenti në të cilin është arsimi i lartë në Shqipëri, kanë parashtruar kërkesa të reja në nivel të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, kështu gjatë takimit me stafin e departmentit në FEUT, u evidentua përcaktimi i një prej pedagogëve si koordinator projektsh dhe departamenti po synonte të ishte me proaktiv në këtë drejtim. Gjithashtu, departamenti ka hartuar një Strategji në ndërkombëtarizimit, e cila do të jetë pjesë integrale e Strategjisë së ndërkombëtarizimit të FEUT, nisur dhe nga përvojat e hershme të tij.</p> <p><i>Dokumenti 132: Marrëveshjet Erasmus UT</i></p> <p><i>Dokumenti 31.1: Projektet ndërkombëtare</i></p> <p><i>Dokumenti 31.2: Projektet kombëtare</i></p> <p><i>Dokumenti 82: Strategjia e ndërkombëtarizimit të departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 31.4: Publikime në WEB për thirrje për projekte</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Në lidhje me bashkëpunimin për kërkimin shkecor të personelit akademik me studentët duket që dy janë rrugët kryesore të përdorura:</p> <p>Së pari, konferenca ndërkombëtare e organizuar nga fakulteti;</p> <p>Së dyti, konferenca e studentëve;</p>



	<p>Një pjesë e periudhës për të cilin bëhet akreditimi lidhet me pandeminë dhe pothuaj i gjithë aktiviteti universitetit u zhvendos online dhe ky është një fakt që në Shqipëri ka ndikuar në mjaft procese, bashkëveprimin pedagog-student për kërkimin përfshirë.</p> <p><i>Dokumenti 62: Proceeding COCEFKS vol 1</i></p> <p><i>Dokumenti 31.5: Publikime në WEB për konferenca</i></p> <p><i>Dokumenti 31.10: Publikime në WEB për konferenca studentore</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Periudha të cilën marrim në shqyrtim përputhet me atë të mësimin online, ku pati vështirësi reale të ndërveprimit për aktivitete ekstrakurrikul me studentët.</p> <p><i>Në lidhje me këtë kriter kërkohet më shumë angazhim nga të gjithë universitetet shqiptare, është një hendek që ekziston në drejtim të lidhjes së universitetit me industrinë. Në takimin në FEUT me zvdekanin për sipërmarrjen u diskutua që krijimi i një skeme që do mundësonte bashkëpunimin universitet – biznes, përtej nevojës së tyre për punonjës është një proces që duhet sfiduar.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Punimet e mikrotezës për studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore udhëhiqen nga një staf akademik me tituj e grada shkencore. Punimi i diplomës ka një strukturë plotësisht të përcaktuar dhe përtej përgatitjes së studentëve në lëndën “Metoda kërkimi”, realizimi i kërkimit empirik ka nevojë për suportin e pedagogut udhëheqës, i cili e mundëson jo vetëm pjesën përmbajtësore dhe strukturore, por dhe mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre, etj. Kjo realizohet përmes orëve të tëra të konsultimit dhe të suportit që pedagogët i japin studentëve.</p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzuesi i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 114: Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës së MSH</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.7</p> <p>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UT, si institucioni lider i arsimit të lartë në vend ka një plan strategjik të kërkimit shkencor për periudhën 2018-2022, të formuluar me të gjithë elementët nga qëllimet deri tek financimi. Në dy vitet e fundit ka një lëvizje të IAL-ve në vend në lidhje me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor së bashku, si një përpjekje e qenësishme e tyre dhe qeverisë për të rritur cilësinë e arsimit të lartë, për ta bërë atë të konkurrueshëm dhe për të bërë produktin e tij të vlefshëm në tregun lokal e më gjerë. Pikërisht, për këtë arsye, Departamenti i Menaxhimit ka hartuar strategjinë e tij të ndërkombëtarizimit, e cila një fokus ka dhe në punën me projekte dhe kërkim të mirëfilltë shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Nëse do t'i referoheshim dokumentit përmbledhës të punës kërkimore –shkencore të 5 viteve të fundit të Departamentit të Menaxhimit që mbulon programin MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore që akreditohet, do të evidentonim:</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - numri i artikujve shkencorë të botuar - 36; - numri i konferencave shkencore – 77; -numri i projekteve kërkimore të fituara në rang departamenti/fakulteti -8; -numri i projekteve kërkimore të zbatuara në rang departamenti/fakulteti – 11; - numri i konferencave shkencore të organizuara për programin e studimit-3; - libra të botuara – 9; - monografi shkencore – 1; - mobilitete të tjera - 48.
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Ky produkt i punës shkencore, vjen si rezultat i bashkëpunimit të profesorëve senjor të departamentit, me profesorët më të rinj, doktorët e shkencave dhe asistentët. Hapja e ciklit të tretë të studimeve doktrale, është një mundësi për t'i dhënë një dimension të ri punës kërkimore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, argument ky i trajtuar gjatë vizitës në institucion. Mobilitetet Erasmus bëjnë që profesorët incoming të shërbejnë për të shpërndarë përvoja akademike e të kërkimit me shumë vlerë brenda departamentit dhe fakultetit, për stafin dhe studentët.</p>

	<p><i>Dokumenti 116: Plani strategjik i UT për kërkimin shkencor për periudhën 2018-2022.</i></p> <p><i>Dokumenti 82: Strategjia e ndërkombëtarizimit – Departamenti i Menaxhimit</i></p> <p><i>Dokumenti 64: Përmbledhje e aktivitetit kërkimor –shkencor, 5 vitet e fundit;</i></p> <p><i>Dokumenti 32: Projekte ndërkombëtare</i></p> <p><i>Dokumenti 31-12 dhe 13: Publikime në WEB të leksioneve të hapura me profesorë të huaj</i></p> <p><i>Dokumenti 31-1: Publikime në WEB të trajnime, punësime, mobilitete, etj.</i></p> <p><i>Dokumenti 127: Urdhër nr 156, dt. 24.03.2022 për organizimin e programit të doktoraturës për “shkencat ekonomike”</i></p> <p><i>Dokumenti 126.2: Thirrje për hapjen e programit të doktoraturës</i></p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, në Dosjen e programit MSHAB me profile në Menaxhim dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe në veçoritë e formulimit të Planit Mësimor, në silabuset e lëndëve, në udhëzuesin e temës së diplomës, në formatin e mikrotezës dhe orët që i dedikohen në Plan punimit të mikrotezës, si dhe gjithashtu në diskutimet e bëra gjatë vizitës në institucion me stafin e programit të studimit, mund të themi që MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore garanton më së miri synimet për të cilat shërben një master i shkencave, në aktet ligjore të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Në kohë, ky master ka shërbyer për të siguruar prurjen e të rinjve në Departament dhe tashmë pas hapjes së ciklit të tretë të studimeve pas një periudhe shumë të gjatë do të ketë mundësinë, që studentët më të mirë të këtij masteri të ndjekin dhe ciklin e tretë të studimeve. Po këtij qëllimi i kanë shërbyer konferencat e studentëve të masterit dhe angazhimi i studentëve me pedagogët në konferencat shkencore ndërkombëtare</p> <p><i>Dokumenti 7.1: Rregullore e Programit të Studimit MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 14: Dosja e Plotë e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 18, 1 dhe 2: Silabuset e lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 79: Udhëzues i temës së diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 80.1: Formati mikrotezës së MSH</i></p> <p><i>Dokumenti 126.2: Thirrje për hapjen e programit të doktoraturës</i></p> <p><i>Dokumenti 31.10: Publikime në WEB i konferencës studentore</i></p>


	<i>Dokumenti 62: Proceedings COCEFKS vol 1</i>			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	<p>FEUT ka pasur eksperiencën e shkëlqyer të masterit MBA me Universitetin e Linkolnit të Nebraskës, kështu që ka të gjithë eksperiencën dhe traditën për të nisur mësimdhënien në gjuhë të huaj- angleze kryesisht. Kjo mbetet një nga aspektet që departamenti do të planifikojë të bëjë për periudhën në vijim dhe në përputhje me strategjinë e ndërkombëtarizimit të formuluar.</p> <p><i>Një sugjerim për Departamentin dhe fakultetin është që në drejtim të ndërkombëtarizimit dhe të projekteve ka hapësirë për më shumë proaktivitet dhe rezultate.</i></p> <p><i>Dokumenti 82: Strategjia e ndërkombëtarizimit – Departamenti i Menaxhimit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Në përputhje me Statutin e UT, në njësinë kryesore dhe atë bazë funksionojnë një sërë zyrash të cilat mbështesin studentët në plotësimin e një tërësie procesesh dhe aktiviteteve të domosdoshme për procesimin gjatë studimeve master.</p> <p>Brenda fakultetit, Zyra e Informimit të Studentëve, Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Zyra IT, koordinatori i programit drejtuesi i departamentit dhe stafi i tij ndihmojnë studentët për qartësimin e elementëve të ndryshëm në procesin nga regjistrimi i tyre deri në marrjen e diplomës.</p> <p>Pedagogët gjithashtu komunikojnë me studentët dhe gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin online, përmes sistemit MS Teams ata kanë ndërvepruar me studentët duke dërguar materialet, bërë mësimin me regjistrim dhe duke ju përgjigjur kërkesave të tyre përmes platformës. Në këtë periudhë në</p>

<p>procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>shërbim të studnetëve u vendosën udhëzues dhe u hartuan rregullore të posaçme.</p> <p>Një nga kanalet efektive të komunikimit të FEUT me studentët është WEB i fakultetit, në të cilin ata informohen për elementë të shumtë të procesit akademik, por dhe për shumë mundësi e procese të tjera nga konkurset, konferencat, mundësitë për intership, punësim, bursa ersamus, etj.</p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti i UT;</i></p> <p><i>Dokumenti 7.1: Rregullore e organizimit të programit të studimit MSHAB</i></p> <p><i>Dokumenti 104: Rregullore e posaçme për zhvillimin e provimeve online</i></p> <p><i>Dokumenti 105: Manuali i përdorimit të MS Teams</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1-14: Publikime në WEB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Në takimin në institucion me stafin e angazhuar në program, evidentuam që pedagogët e departamentit për shkak të reputacionit të tyre janë këshilluesit më profesionistë të karrierës së studentëve të tyre dhe kjo përbën një vlerë të shtuar për institucionin dhe studentët, në atë çka ata mund të përfitojnë gjatë viteve të studimit.</p> <p>Në FEUT, Zyra e Karrierës është e alokuar në hollin hyrës, duke i dhënë mundësinë studentëve të aksesojnë dhe ndërveprojmë me specialisten e saj.</p> <p>Studentët e MSHAB me profil: Menaxhim; Menaxhim i Burimeve Njerëzore punojnë në masën 80%, numri i studentëve që kërkojnë ndihmë për praktikën është i vogël, megjithatë Zyra i përgjigjet duke komunikuar me subjektet që janë pjesë e listës së marrëveshjeve me FEUT.</p> <p><u><i>Sugjerim që kjo listë të shtohet dhe pasurohet veçanërisht me subjekte të botës së biznesit dhe marrëveshjet të reflektojnë dinamikën që tregu i punës ka sot.</i></u></p> <p>Për vitin 2021-2022 aktiviteti më i rëndësishëm, ka qenë Panairi i Punës, në të cilin kanë marrë pjesë mbi 70 kompani serioze. Zyra e Karrierës dhe Departamenti mbledhin në vijueshmëri informacione mbi studentët e diplomuar, punësimin e tyre, megjithatë ky proces ka vend ende për përmirësim.</p>





	<p><i>Sugjerim tjetër është organizimi i aktiviteteve të Rrjetit Alumni, i cili në rastin e programit që akreditohet do të ishte dhe një histori suksesi.</i></p> <p><i>Dokumenti 12.1: Raport mbi Qendrën e Karrierës</i></p> <p><i>Dokumenti 17: Studim për tregun e punës pas diplomimit të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 77: Rrjeti Alumni i departamentit,</i></p> <p><i>Dokumenti 31 nga 1-14: Publikime në WEB</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe komunikimit me drejtues të IAL gjatë vizitës në IAL, konstatojmë se UT në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT. Kjo njësi është ngritur nëpërmjet Vendimit Nr.12 dt. 18.04.2012 të Senatit Akademik të UT dhe është e përbërë nga 11 anëtarë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional	FEUT si njësi kryesore, nëpërmjet Vendimit Nr 11 dt. 28.09.2021 të Dekanatit të FEUT krijoi Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të



<p>Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Cilësisë të Fakultetit në përbërje të të cilit janë 8 anëtarë, ku çdo departament ka përfaqësuesit e tij.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>E gjithë veprimtaria e NJSBC në rang UT dhe FEUT mbështetet në rregulloret respektive të institucionit. Dega e Sigurimit të Cilësisë, e krijuar në Qershor të vitit 2021 ka hartuar një Raport për vitin akademik 2021-2022. E gjithë veprimtarua e NJSBC së FEUT për vitin 2021-2022 është bazuar në një plan.</p> <p>GVJ vlereson që FEUT për shkak të madhësisë që ka si institucion, ku veçse për këtë program studimi janë me disa qindra të rregjistruar, ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Fakultetit me anëtare nga cdo njesi baze me mandate të qarta dhe raportim në Dekanat. Ngritja e këtij komisioni shërben për nxitjen, promovimin dhe monitorimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në FEUTsi edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi. Në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT.</p> <p>Senati Akademik i UT ka miratuar Rregulloren e Përgjithshme, Manualin e NJSBC, Rregulloren e NJSBC, Planin strategjik të Zhvillimit , si edhe Strategjinë e Zhvillimit të Programit MSHAB të cilat plotësojnë kriteret institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Dokumenti 118: Vendimi i krijimit të NJSBC në UT;</i> <i>Dokumenti 86: Vendimi krijimit të NJSBC FEUT</i> <i>Dokumenti 8-1. Rregullore e NJSBC –UT</i> <i>Dokumenti 8. Rregullore e NJSBC –FEUT</i> <i>Dokumenti 35: Raport i Degës së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 85: Miratimi i Planit të NJSBC të FEUT</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>FEUT si njësi kryesore, nëpërmjet Vendimit Nr 11 dt. 28.09.2021 të Dekanatit të krijoj Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Fakultetit në përbërje të të cilit janë 8 anëtarë, ku çdo departament ka përfaqësuesit e tij dhe nje student.</p> <p>Kjo njësi shërben per monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë. Megjithatë sipas RVB-së, në zbatim të akteve rregullative institucionale përsëri peshë bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të marrë masa organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor, por është anashkuar evidentimi i përgjegjësisë konkrete të NJSBC e cila është Njësia e Posaçme e ngritur nga IAL për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrur dhe rishikur programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në DVV gjenden nga GVJ evidenca për të dokumentuar punën e NJSBC për çdo fund viti akademik për proceset e ndryshme të planveprimit edhe raportin përmbledhës të gjithë aktivitetit vjetor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në DVV nuk gjenden nga GVJ evidenca për të dokumentuar punën e NJSBC si dhe sygjërimet e kësaj njësie për çdo aktivitet të vlerësuar lidhur me programin e studimit të MSHAB</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, ekspertët pyetën përfaqësuesit e NJSBC për:</p> <p>a) Shpeshësinë e raportimit në informimin e drejtuesve të njësive bazë dhe përmes tyre të gjithë stafin mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik.</p> <p>Përgjigja nga NJSBC ishte se përpilohej një raport vjetor, nga drejtuesi i NJSBC.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>U bëmë me dije se shpeshësia e dhënies së opinionëve të tyre ishte edhe javore pasi. Gjithashtu, në pyetësor nuk ka pyetje për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit administrativ nga studentët, për të cilën sugjerojmë FEUT ta marr në konsideratë. Gjithashtu, "...informacioni i përfutur nga këta instrumenta kontrolli pas përpunimit përdoret në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik nga ana e njësive përgjegjëse.</p> <p>b) Ku gjenden të publikuara dhe çfarë përmbajnë raportet vjetore të NJSBCZHK për 2 vitet e fundit?</p>

	<p>Evidencat e depozituara në DVV janë më shumë një raportim për strukturat drejtuese se çfarë detyrash ka kryer kjo njësi dhe jo një analizë e gjetjeve dhe adresimi i tyre përgjatë procesit të vlerësimit të cilësisë për programin e studimit ashtu siç e kërkojnë standardet.</p> <p>Në përfundim, GVJ rekomandon:</p> <p><i>NJSBC të mbaj evidenca për të reflektuar ne raporte te posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit nepermjet analizave për zbatimin e detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive për përmirësimin në vijim të cilësisë.</i></p> <p><i>Dokumenti 118: Vendimi i krijimit të NJSBC në UT;</i></p> <p><i>Dokumenti 86: Vendimi krijimit të NJSBC FEUT</i></p> <p><i>Dokumenti 8-1. Rregullore e NJSBC –UT</i></p> <p><i>Dokumenti 8. Rregullore e NJSBC –FEUT</i></p> <p><i>Dokumenti 35: Raport i Degës së Sigurimit të Cilësisë</i></p> <p><i>Dokumenti 85: Miratimi i Planit të NJSBC të FEUT</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>FEUT ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase tarifat e studimit nga studentët e tij, dhe të sigurojë mbarëvajtjen cilësore të këtij programi studimi jo vetëm deri në diplomimin e studentëve por edhe daljen e tyre në tregun e punës apo sigurimin e trajnimit të vijueshëm të tyre edhe pas diplomimit.</p> <p>Sipas RVB-së, NJSBC raporton tregues, opinione dhe sugjerime që vijnë nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, sondazheve, e fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ata.</p>

<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies: analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore në rang departamenti, dhe më pas në nivel fakulteti të cilat pasqyrohen në raportet përkatëse ku analizohen të gjithë elementët matës të cilësisë; dekanati me strukturat e tij ushtrojnë kontrolle mbi kryerjen e procesit mësimor përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore monitorojnë procesin e mësimin, realizimin e programit mësimor, veprimtarinë kërkimore-shkencore, realizimin e seancave laboratorike të studentëve, procesin e provimeve, performanca e personelit akademik. <i>(Dokumenti 36_Analize vjetore e departamentit (2020-2021); (Dokumentimi039_Pyetesori i departamentit nga NJSBC)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Rol të vecantë luan edhe vlerësimi për programet e studimit nga palë të treta të fushës përkatëse nga sektori publik dhe privat.</p> <p>GVJ konstatoi në raport se kryhen sondazhe apo intervista me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve të këtij programi pavarësisht se edhe sipas manualit të NJSBC i jepet rol i vecantë vlerësimit të programit të studimit nga palë të treta të fushës përkatëse (nga sektori publik dhe privat).</p> <p>Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për të tërhequr mendim dhe vlerësim mbi programin e studimit dhe sa i përgjigjet ai tregut të punës janë dhe studimet e tregut të punës të organizuara nga Fakulteti i Ekonomisë, ku përfshihet dhe Departamenti i Menaxhimit për këtë program. <i>(Dokumenti 017-Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që</p>	<p><i>GVJ i këshillon IAL-së që përveç metodave që ai aplikon duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si sondazhe e intervista me punëdhënësit për studentët e këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Dokumenti 35: Raport i Degës së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 85: Miratimi i Planit të NJSBC të FEUT</i></p>

bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar RVB nuk shprehet qartë lidhur me këtë standard, por referuar Evidencave të depozituara në AMS mund të evidentojmë se Senati Akademik i UT është siguruar që përmes miratimit të SBC Rregullores së Përgjithshme të NJSBC të përfshijë aktorë të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit përmes citimit në nenin 4 dhe 5 të Manualit të SBC ku përcaktohet ngritja e GVB dhe në përbërje të tyre të ketë përfaqësues të studentëve, stafit akademik dhe atij ndihmësakademik apo administrativë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ në Rregulloren e Përgjithshme të NJSBC konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> ● Eshtë përcaktuar përbërja e NJSBC e cila nuk ka asnjë përfaqësim nga aktorë të jashtëm të interesuar të tillë si punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj. Siç rezultoi nga evidencat e vëna në dispozicion për vlerësimin e jashtëm, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë (Departamenti i Menaxhimit) dhe njësia kryesore (FE) me strukturat e tij. Roli i tyre është i mirë përcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësisë në UT. (Dokumenti 084- Vlerësimi për Pedagogun nga cdo
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet	

<p>të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>student); (Dokumenti 078-Shembull vlerësim performance, pedagog, lektor, shef departamenti);</i></p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka evidenca (dokumenta) që tregojnë përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj dhe çfarë janë reflektuar në realitet nëse ka pasë të tilla takime.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p><i>(Ligji i Arsimit të Lartë (80-2015 i datës 22.07.2015);</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Statuti UT</i></p> <p><i>Dokumenti 5: Rregullore UT</i></p> <p><i>Dokumenti 8-1. Rregullore e NJSBC –UT</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VL5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret por ka përsëritje të përgjigjeve, si edhe ka mungesë të referencave dhe evidencave. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</p> <p>Bazuar ne RVB, FEUT përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion pretendentëve (drejtues, pedagogë, të tjerë të interesuar).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve në FEUT ka shërbyer për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së pedagogëve dhe sipas GVB në ndonjë rast ka pasë edhe marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndërsa NJSBC nuk na konfirmoi ndonjë gjetje materiale të marrë nga studentët dhe si rrjedhim nuk ka pasë asnjë masë të marrë. Kjo për GVJ do të thotë se ka paqartësi edhe brenda vetë FEUT lidhur me punën e NJSBC.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sipas RVB konstatohen disa rast/gjetje të konsideruara si problemet më kryesore të cilat kanë qënë të lidhura me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Si edhe për ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve në FEUT është arritur përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Një tjetër kërkesë e një kriteri në këtë standard është për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. GVJ gjatë vlerësimit të RVB, website të IAL-së, si edhe evidencave të depozituara në AMS nuk konstaton që IAL të ketë plotësuar kërkesën e këtij kriteri duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të FEUT të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë nuk sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. Në përfundim, GVJ i sugjeron IAL-së, të merren masat për:</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p><i>Publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: Administrim Biznesi me profile: a. Menaxhim; b. Menaxhim i burimeve njerëzore

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Brandi i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, si fakulteti pionier i programeve Master në Shqipëri. Masteri i parë në Shqipëri e ka zanafillën e vet në vitin 1993, me programin MBA të realizuar nga FEUT në bashkëpunim me Universitetin e Linkolnit të Nebraskës;
2. Trupë akademike në përbërje të të cilit janë personalitete të disiplinës së menaxhimit në vend, me një kontribut të vyer profesional, akademik dhe të kërkimit. Departmenti ka në përbërje 33 pedagogë nga të cilët 6 janë me titullin “professor” dhe 6 të tjerë me titullin “profesor i asociuar”;
3. Infrastruktura e Fakultetit me investimet e fundit të bëra në të krijon një mjedis dinamik dhe në standarde europiane ;
4. Cilësia e studentëve që në vite kanë ndjekur masterin e shkencave në Administrim _ Biznes, që përforcohet dhe nga lista e alumnit të këtij program në vite ;
5. Menaxhim me vizion i departamentit duke harmonizuar më së miri brezat e pedagogëve, synuar sot ndërkombëtarizimin dhe punën me projekte dhe menaxhimin formal dhe të strukturuar duke krijuar një përvojë që ja vlen të theksohet e të përdoret si një praktikë e mirë ;

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit që do të lehtësonte komunikimin dhe ndërveprimin student-pedagog-administratë-sekretari mësimore; *(Standarti V.2 kriteri 3)*




2. Eshtë e nevojshme të aplikohet një qasje strategjike për shfrytëzimin e marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit në nivel institucional për qëllime specifike të programit MSHA; (*Standarti I.3 kriteri 6*)


Rekomandime

1. Formalizimi i mëtejshëm i marrëdhënieve të departamentit dhe fakultetit me biznesin, duke ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrinë dhe duke gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/interhipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentimin etj. Përfshirja në silabuse i shumë aktiviteteve që realisht pedagogët e departamentit zhvillojnë dhe krijimi i një database të departamentit për lidhjet me industrinë;
2. Të punohet për një strategji ndërkombtarizimi të fakultetit dhe të sinkronizuar me njësitë bazë, programet në gjuhën angleze, programet e përbashkta me universitetet europiane, etj;
3. Mund të punohet për ndërtimin e një metodologjie që mundëson vlerësimin e punës shkencore, që përcakton dhe peshon indikatorët dhe që mund të shërbejë si një nga treguesit e vlerësimit të performancës dhe të shpërndarjes së buxhetit për kërkimin shkencor. Të punohet për një botim shkencor të fakultetit që i ka të gjitha kapacitetet njerëzore për ta mundësuar një produkt shkencor cilësor;
4. Akreditimi programit lehtëson dhe përirësimi dhe përfshatje të programit në përputhje me zhvillimet e reja;

Evaluation results of the second cycle study program Master of Science in: Business Administration profiles: a.Management; b.Human resources Management

a. Strengths and Affirmations:

1. The brand of the Faculty of Economics of the University of Tirana, as the pioneer faculty of master's programs in Albania. The first master's degree in Albania had its origins in 1993, with the MBA program realized by FEUT in cooperation with the University of Lincoln;
2. Nebraska. Academic body composed of personalities from the discipline of management in the country, with a significant professional, academic and research contribution. The department has 33 lecturers, 6 of whom have the title of "Professor" and 6 have the title of "Associate Professor";
3. The infrastructure of the Faculty with the recent investments made in it, creates a dynamic environment and European standards;





4. The quality of students who over the years have followed the Master of Science in Administration - Business, which is reinforced by the local and international success of the alumni of this program over the years;
5. Visionary management of the Department by harmonizing the generations of lecturers, aiming and inspiring internationalization and project work; as well as guaranteeing formal and structured management, which has created a worth experience and using as a good practice in Albanian universities;
6. Internationalization strategies at the Faculty and Department level demonstrate a long-term and serious approach in accordance with the National Higher Education Strategy and European developments;

b. Weaknesses:

1. University of Tirana has an information management system with students, which should be improved and further integrated, to better respond to the demands of the digital transformation of education; (*Standart V.2 criteria 3*)
2. It is necessary to apply a strategic approach for the use of the agreements at the institutional level for specific program purposes; (*Standart I.3 criteria 6*)

Recommendation

1. Digital transformation should be considered an institutional and departmental challenge;
2. To work for a scientific publication of the Faculty and for the intensification of the industry-university relations with the improvement;
3. The department should consider on working on a methodology that should enable the evaluation of the scientific work and also can determine the indicators that can serve to evaluate the performance and the distribution for the budget of the scientific work;
4. The accreditation of the study program facilitates and permits adaption of the program in accordance with new developments;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X